



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
8. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)

6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.

7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)

8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.

9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

10. Edmon Hoxhaj, BIRN.

11. Petrika Thano, MCA-PRESS.

12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

13. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në fakt, edhe një herë përshëndes kolegët e rinj që janë midis nesh dhe që do i japin Këshillit energji të reja për vijimin e funksionalitetit të Këshillit.

Ashtu sikurse ju kemi bërë me dije, mbledhja e sotme në fakt është një mbledhje e cila ka çështje, ka rreth 15 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit. Ju informova që kemi shtuar jo më larg se dje një nga çështjet që ka të bëjë me caktimin e një gjyqtari. Është shumë e domosdoshme sepse gjykatat që janë në nevojë bëjnë kërkesa për plotësimin e trupave prandaj për këtë hidhet me short.

Gjithashtu, siç ju kam vënë në dijeni, sot kemi edhe shqyrtimin e ngritjes dhe përbërjen e komisioneve.

Në cilësinë e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mbajtjen në vëmendje të hartimit dhe propozimit për komisionet, kanë qenë disa faktorë shumë të rëndësishëm (pasi Kryetarja është edhe autoriteti i cili kujdeset për miradministrimin e Këshillit):

E para, që ndërhyrjet që ne bëmë në dhjetor të vitit të kaluar (të paktën midis nesh) e folëm që do ishin ndërhyrje të një karakteri të përkohshëm, për të parë mundësinë që me prurjet e reja dhe me plotësimin e mandateve të bëhej riformatimi i plotë i Komisioneve të Këshillit.

Roli i Komisioneve të Këshillit, ai që është në Këshill e kupton shumë mirë, sepse janë zemra e Këshillit. Nëse nuk funksionojnë mirë komisionet, pa diskutim që Këshilli nuk ka ritëm dhe nuk realizojmë prioritetet tona. Është shumë e nevojshme ta theksoj që deri më sot ne kemi pasur praktika shumë të mira për sa i përket komisioneve dhe mënyrën se si i kemi krijuar, me një mirëkuptim, ndoshta edhe me diferenca për një ose dy, por thelbi i të gjithë trupës që Këshilli ka pasur ka qenë që të bëjmë punën funksionale në Komision.

Këshilli punon si një organ i vetëm dhe komisionet janë pjesë e këtij organi, që duhet të punojnë me të njëjtin ritëm si punojnë të gjithë të tjerët.

Ajo që unë kam pasur parasysh në propozimin që ju kam parashtruar, ka qenë e para, prioritetet që ka Këshilli, e cila është një gjë shumë e rëndësishme;

Kam marrë parasysh eksperiencën e gjithsecilit prej jush;

Mënyrën se si ju i qaseni Këshillit, sepse kjo ka të bëjë me pjesën e krijimit të ekuilibrave brenda komisioneve dhe harmonisë që keni për të vepruar;

Gjithashtu jam kujdesur që të kemi një memorie në secilin komision. Pse e them këtë? Sepse ajo që unë e vë në evidencë, kur një komision është i krijuar komplet me të rinj, krijon një lloj vështirësie në pjesën e menaxhimit, dhe memoria është shumë e rëndësishme. Personalisht, çështjen e memories institucionale e kam pasur një nga gjërat më primare (edhe unë si titullare e institucionit), ku jam e bindur që nëse ne nuk do kishim stafin që ishte memorie e ish-KLD-së por edhe ish-ZABGJ-së, pa diskutim që Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk do kishte arritur në këto nivele që ka arritur, vetëm për shkak të punës së anëtarëve. Ajo që kemi pasur parim është që, unë e them pa hezitim kudo, është që anëtarët që kam pasur nderin të punoj, kanë pasur një dedikim shumë të madh lidhur me punën dhe kjo ka bërë që edhe me eksperiencën e stafit Këshilli ka arritur, sot që ne flasim, me standarde, flasim me një numër të konsiderueshëm të miratimit të akteve nënligjore, pra mund të themi që e kemi pothuajse të mbaruar kuadrin rregullator normativ; flasim me standarde të krijuara dhe me promovime bazuar mbi meritokraci dhe objektivizëm, dhe kjo është falë dhe vetëm falë punës dhe mënyrës së organizimit që kemi pasur ne këtu.

Kështu që unë mund të them vetëm praktikën më të mirë që Këshilli ka ndeshur në këtë proces dhe ka pasur, ku prioritarë ka qenë si të funksionojmë sa më mirë.

Mbi këto parime dhe duke parë edhe pjesën e preferencave që ju keni parashtruar paraprakisht, secili prej jush, siç kemi zbatuar edhe herë tjetër procedurën, ka parashtruar preferencat dhe unë i kam realizuar, kam hartuar këtë propozim mbështetur mbi ato preferenca që ju keni dhënë, dhe besoj të gjithë e dini që nuk kam përfshirë asnjë kundër preferencës së dhënë prej jush.

Kështu që kjo është arsyeja që unë propozoj këtë format komisionesh, duke iu uruar pjesës së re që na vijnë, të kenë të njëjtën energji, që besoj deri tani e kanë treguar që qasjen pro Këshillit dhe në proaktivizimin që ato kanë; dhe unë propozoj si më poshtë:

Tek Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit propozoj veten time, që të vazhdoj të qëndroj në këtë komision. Propozoj zotin Ridvan Hado. Propozoj zonjën Yllka Rupa. Anëtarë zëvendësues, zonja Emona Muçi dhe zotin Albens Tabaku.

Tek Komisioni Disiplinor, propozoj zotin Ridvan Hado, zonjën Emona Muçi dhe zotin Bledar Bajri; dhe anëtarë zëvendësues, zotin Markelian Koça dhe zotin Ilir Rusi.

Gjithashtu, tek Komisioni i Vlerësimit të Etikës, propozoj zonjën Irena Plaku, zonjën Gentiana Muçaj, zotin Ilir Rusi; dhe anëtarë zëvendësues, zotin Ridvan Hado dhe zotin Bledar Bajri.

Ndërkohë, tek Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, është zoti Klodian Kurushi, zoti Markelian Koça, zoti Albens Tabaku; dhe zonja Emona Muçi dhe zonja Yllka Rupa.

Sjell në vëmendje që për anëtarët e rinj që nuk kanë mbushur 2... dhe për ato që erdhën në dhjetor, Këshilli ka mundësi që t'i rinovojë prapë dhe ato kërkesa që nuk janë realizuar, pra si kërkesa parësore, mund t'i keni gjatë mandatit të dytë. Ky formatim është një formatim për këtë lloj, për të zëvendësuar ato që kanë mbaruar mandatin e parë, por edhe për të marrë në konsideratë kërkesat e anëtarëve të tjerë.

Kështu që, ky është propozimi im.

Po zonja Muçi!

Emona Muçi: Atëherë, pasi dëgjuam propozimin në lidhje me ndryshimin e vendimit nr. 13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, të ndryshuar, unë propozoj që, në lidhje me sa dëgjuam, të respektohet neni 62 i ligjit 115/2016 i cili në pikën 12 thotë: Anëtarët e Komisioneve i ushtrojnë funksionet e tyre pranë komisioneve për dy vite e gjysmë nga data e zgjedhjes së tyre. Në përfundim të kësaj kohe përbërja e komisioneve ndryshohet sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të nenit 62 të këtij ligji.

Për këtë arsye unë bëj propozimin që anëtarëve të cilëve nuk u ka përfunduar afati prej dy vjet e gjysmë, të qëndrojnë në komisionet ku ata bëjnë pjesë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, atë u mundova t'ju sqaroja.

Ne që në mbledhjen e kaluar, anëtarët që ishin, e kishin të qartë që neve do ta ndryshonim Këshillin tërësisht në momentin që do vinte shumica tjetër nga jogjyqtarët,

kështu që prandaj kam rivlerësuar në këtë lloj mënyre pjesën e Këshillit. Kështu që, nëse kemi ndonjë diskutim?

Atëherë, unë propozoj të kalojmë në votim propozimin tim, të komisioneve.

Emona Muçi: Edhe i imi. Duhet të kalojë njëherë i imi, pastaj i juaji.

Naureda Llagami: Je vetëm ti. Je duke folur për të gjithë anëtarët.
Fol për veten tënde. S'mund ta ngresh në votim për...

Emona Muçi: Atëherë, për veten time.

Naureda Llagami: Atëherë, thuaj...

Emona Muçi: Atëherë, për veten time.

Naureda Llagami: Atëherë, këtë thuaj pra.

Emona Muçi: Pra, në bazë të nenit 62, pika 12, anëtarët...

Naureda Llagami: Nuk e the kështu.

Emona Muçi: S'jam vetëm për veten time.

Naureda Llagami: Ti s'mund të flasësh... Mona, proceduralisht do flasësh për propozimin tënd.

Emona Muçi: Atëherë, në datën 26, kur folën anëtarët, që na propozuan, nuk folën për veten e tyre, folën për të tjerët. Kështu që edhe unë po bëj të njëjtin propozim ju lutem. Po bëj të njëjtin propozim. Ky është propozimi im. Hidheni në votë. Unë e bëra

6

propozimin. Ne këtu kemi parasysh ligjin 115/2016, neni 62 është i qartë, thotë: Anëtarët janë me mandat, domethënë zgjidhen për një kohë dy vjet e gjysmë nga momenti i zgjedhjes. Unë kam qëndrimin që të respektojmë ligjin, dhe them që të gjithë anëtarët e komisioneve të cilëve nuk u ka përfunduar ky afat, pa emra, në qoftë se do emra, Emona Muçi, të qëndrojnë deri në përfundim sipas pikës 12 të këtij ligji. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po pra... Ti fol për vete, nuk mund të flasësh në shumës.

Atëherë, propozimi për zonjën Muçi, që të ketë afatin dyvjeçar, pavarësisht që zonja Muçi e ka shumë të qartë që në propozimin që unë kam bërë në cilësinë e Kryetares në dhjetor, ka qenë me karakter të përkohshëm.

Kalojmë në votim?

Emona Muçi: Një sekondë të lutem.

Atëherë, ligji nuk ka ndonjë parashikim të karakterit të përkohshëm apo të përgjithshëm....

Naureda Llagami: Ligji ka parashikimin që Kryetarja e KLGJ merret me miradministrimin e komisioneve.

Kalojmë në votim të lutem propozimin e zonjës Muçi.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Kundër.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet me shumicën e votave kundër.)

Naureda Llagami: Kalojmë pra në votimin, duke qenë se u rrëzua, kalojmë në votimin e projektvendimit sipas propozimit të ardhur.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord me propozimin e Kryetares.

Albens Tabaku: Dakord, pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet propozimi sipas asaj që unë lexova.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, të ndryshuar” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.¹

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Bledar Bajri* (anëtar)
8. *Albens Tabaku* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*

12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

13. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, të ndryshuar” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 18.01.2024 “Për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë në dy projekt-akte të cilat edhe këto kanë të bëjnë me zëvendësimin dhe plotësimin e komisioneve të përkohshme.

Së pari kemi, siç ju thashë, kemi të bëjmë me zëvendësimin me short të dy anëtarëve, që janë për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë. Kështu që, ftojme administratën që të hedhë shortin.

Siç e dini, nga akti që kemi miratuar për ngritjen e këtij Komisioni, ky akt ka si qëllim që dy anëtarët do zgjidhen nga jogjyqtarët dhe në gogla do të jenë të përfshirë zoti Rusi, zonja Rupa, zoti Tabaku dhe zoti Bajri.

Procedura e shortit si vijon (për çështjen e parë):

Në enën e qelqit vendosen me radhë shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve: z. Albens Tabaku, z. Bledar Bajri, z. Ilir Rusi dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet gogla e parë. Zoti Bledar Bajri është i përzgjedhuri i parë.

Përzgjidhet gogla e dytë. Zoti Ilir Rusi është i përzgjedhuri i dytë.

Naureda Llagami: Atëherë, tek Komisioni që ka të bëjë me shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duhet të zëvendësojmë zonjën {...} me një anëtar jogjyqtar. Të hedhim shortin dhe pastaj i kalojmë secilin në votim. Pra zonja {...} do zëvendësohet... Do futen në enë emrat e të gjithëve. Një do zëvendësojmë.

Pra, Komisioni aktualisht është i përbërë nga znj. Yllka Rupa, nga znj. Irena Plaku dhe nga z. Ilir Rusi. Anëtarë zëvendësues është zoti Markelian Koça dhe ka qenë zonja {...}. Duke qenë se zonja {...} nuk është më anëtare e Këshillit, duke qenë se zonja Rupa dhe zoti Rusi janë anëtarë të Komisionit, do hidhet shorti për zotin Tabaku dhe për zotin Bajri, duke qenë se Kryetarja nuk përfshihet, pasi është shqyrtim i akteve individuale.

Procedura e shortit si vijon (për çështjen e dytë):

Në enën e qelqit vendosen me radhë shiritat e letrës me emrat e dy anëtarëve jogjyqtarë: z. Albens Tabaku dhe z. Bledar Bajri.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet gogla dhe anëtari i përzgjedhur si anëtari zëvendësues është zoti Bledar Bajri (në vend të zonjës {...}).

Naureda Llagami: Kemi një lapsus që ka ndodhur kur kemi hedhur shortin për anëtarët zëvendësues tek komisioni tjetër. Duke qenë se zoti Rusi, nga anëtar zëvendësues që ishte, është bërë i përhershëm. Kështu që bëhemi gati për short dhe ndërkohë ne vazhdojmë me rendin e ditës.

Pra paraparakisht kalojmë në miratimin vetëm të projekt-aktit për një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2024”, me këtë përmbajtje:

Përbërja e Komisionit të Përkohshëm është:

1. Znj. Yllka Rupa – Kryetare;
2. Znj. Irena Plaku– anëtare;
3. Z. Ilir Rusi – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni janë:

1. Z. Markelian Koça – anëtar;
2. Z. Bledar Bajri – anëtar.

Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet Komisioni.

Naureda Llagami: Kurse për Komisionin tjetër kemi edhe një short për të hedhur.

Për ta miratuar e lëmë në fund.

(Pas trajtimit të të gjithë çështjeve të rendit të ditës (pikat 4 deri në 15), rivijon çështja aty ku u la me hedhjen e shortit për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për

verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, të ndryshuar (shih faqen 4, fjala e Kryetares.)

Naureda Llagami: Siç e lamë kemi hedhjen e shortit për plotësimin e një nga Komisionet e Përkohshme, për të cilat në fakt nga ana e administratës ishte bërë një lapsus si për pjesën kush anëtarë do plotësoheshin dhe për pjesën tjetër kishim marrë një variant jo të përditësuar.

Shkurtimisht, më sillni pak variantin e përditësuar.

Atëherë, varianti që kemi pasur të përbërjes së Komisionit ka qenë:

Zonja {...}; zoti {...} dhe z. Ridvan Hado (anëtarë të përhershëm të Komisionit).
Dhe kanë qenë anëtarë zëvendësues zonja Irena Plaku dhe zoti Ilir Rusi.

Ajo që ne diskutojmë tani duke qenë se zonja {...} dhe zoti {...} largohen, atëherë duhet të plotësojmë vetëm këto të dy, jo zëvendësuesit.

Kështu që z. Ilir Rusi dhe znj. Irena Plaku, janë zëvendësues, pra nuk do ndryshojnë.

Rrjedhimisht shorti i bie që të hidhet ndërmjet zotit Albens Tabaku, zotit Bledar Bajri dhe zonjës Yllka Rupa për dy pozicionet e përhershme, si anëtarë jogjyqtarë të Komisionit.

Edhe një herë procedura e shortit si vijon (për çështjen e parë):

Në enën e qelqit vendosen me radhë shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve jogjyqtarë: z. Albens Tabaku, z. Bledar Bajri dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet gogla e parë. Zoti Albens Tabaku është i përzgjedhuri i parë.

Përzgjidhet gogla e dytë. Zoti Bledar Bajri është i përzgjedhuri i dytë.

(Në kushtet kur kjo çështje e rendit të ditës që lidhet me një ndryshim në vendimin nr. 302, datë 05.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm [...]”, pas hedhjes së shortit nuk pati kundërshtime nga ana e anëtarëve si dhe kaloi për votim më herët, atëherë konsiderohet i miratuar.)

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, edhe një herë Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit, përbëhet nga dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar si më poshtë:

1. Z. Albens Tabaku – anëtar i KLGJ-së.
2. Z. Bledar Bajri – anëtar i KLGJ-së.
3. Z. Ridvan Hado – anëtar i KLGJ-së.

Dy anëtarët zëvendësues, siç e përmenda në fillim:

1. Z. Ilir Rusi dhe 2. Znj. Irena Plaku.

* * *

(Pika 2 dhe 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (2 civile dhe 3 penale):

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.
- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës civile”.
- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.
- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës sa Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.
- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës sa Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Irena Plaku (anëtare)*
- 5. Gentiana Muçaj (anëtare)*
- 6. Ridvan Hado (anëtar)*
- 7. Bledar Bajri (anëtar)*
- 8. Albens Tabaku (anëtar)*
- 9. Markelian Koça (anëtar)*
- 10. Yllka Rupa (anëtare)*
- 11. Emona Muçi (anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

10. Edmon Hoxhaj, BIRN.

11. Petrika Thano, MCA-PRESS.

12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.

13. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (2 civile dhe 3 penale):

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës civile”.

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës sa Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.

- “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës sa Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lire në fushën e të drejtës penale”.

Naureda Llagami: Pa humbur kohë kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit, janë disa projektvendime në fakt, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë (në 5 pozicione), në pozicione civile në mos gaboj dhe tre pozicione penale.

Zoti Kurushi shkurtimisht nevojën e hapjes së tyre.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, bashkëlidhur projektvendimit po prezantoj relacionin për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira, dy në fushën e së drejtës civile dhe tre në fushën e së drejtës penale.

Situata aktuale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është analizuar kjo situatë dhe për shkak të analizës ne kemi bërë dhe propozimet përkatëse për hapjen e vendeve të lira.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar organikës si vijon më poshtë: Ka një strukturë organike prej 80 gjyqtarësh; Organika në fakt është 66 gjyqtarë dhe efektivisht në detyrë janë 56 gjyqtarë.

Bashkëlidhur relacionit keni të integruar edhe gjyqtarët që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Së bashku me gjyqtarët është edhe një tabelë tjetër më pas që përcakton edhe ngarkesën e dosjeve që kanë në proces gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë (si në dhoma civile ashtu edhe në dhoma penale), sa kanë hequr si gjyqtarë dhe sa çështje janë të regjistruara tek gjyqtarët që ushtrojnë funksionin pranë kësaj gjykate. Pra po të shikoni tabelën do të shikoni që gjithsej janë 4 vende të lira. Referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Këshilli mundet që për një periudhë që ai e parashikon prej tre muajsh, ka të drejtën për të hapur edhe një vend të lirë, për sa kohë ai planifikon që për tre muaj ky vend do të bëhet i lirë. Ne 4 vende i kemi të lira aktualisht. Kemi propozuar 5 sepse mendojmë që në vijim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm edhe një vend i lirë i pestë do të jetë potencialisht i lirë brenda një afati kohor prej tre muajsh. Si e bëjmë këtë? Kemi një gjyqtare që është {...} e cila është në fund të procesit të vlerësimit të saj. Kandidon me një person tjetër. Por njëkohësisht kemi edhe gjyqtarë të Gjykatës së Tiranës që kanë shprehur interesin për të shkuar si në Gjykatën e Apelit ashtu edhe në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të shkallës së parë, dhe potencialisht një pozicion që ne mendojmë që mund ta përfundojmë brenda afatit tremujor është një pozicion për të cilin konkurrojnë dy gjyqtarë të dhomës penale të

Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Njëri prej të cilëve, brenda tre muajve do shkojë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo është arsyeja pse ne hapim dhe i paraprijmë punëve nëpërmjet propozimit që në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë propozojmë që të hapen 5 vakanca të lira.

Atëherë, për të plotësuar vakancat në këtë gjykatë, njëkohësisht për të përballuar ngarkesën e madhe të çështjeve, Këshilli përgjatë periudhës 2023-2024 ka përdorur dy mekanizma për të zbutur nivelin e ngarkesës në drejtim të shqyrtimit të çështjeve që ka Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këto dy mekanizma janë: i) lëvizja paralele dhe ii) transferimi i përkohshëm me pëlqim.

Gjatë vitit 2023 Këshilli hapi 10 (dhjetë) procedura të lëvizjeve paralele (pozicionet nr. 11- nr.20) nga të cilat janë përmbyllur me sukses 9 (nëntë) prej këtyre procedurave duke u transferuar nëpërmjet lëvizjeve paralele 9 (nëntë) gjyqtarë. Për njërin prej të cilëve ka mbetur në proces procedura e lëvizjes paralele. Vijon pra procedura për pozicionin nr. 14 (ju bëj me dije që është kandidati i vetëm z. {...} për të cilin vijon procedura).

Ndërkohë, procedura e transferimit të përkohshëm me pëlqim, ishte gjithashtu një mekanizëm i përdorur nga Këshilli gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 u transferuan përkohësisht me pëlqim 7 (shtatë) gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këshilli ka përsëritur transferimin me pëlqim për 3 (tre) prej gjyqtarëve. Për rastet e tjera transferimi i përkohshëm me pëlqim ka përfunduar përpara afatit pasi gjyqtarët janë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele.

Gjatë vitit 2024 Këshilli hapi 12 (dymbëdhjetë) procedura të lëvizjeve paralele (pozicionet nr. 73-81 dhe nr. 238-240) ku aktualisht nga 12 procedura të hapura, ka përfunduar me sukses dhe është transferuar vetëm një gjyqtar në pozicionin nr.77. Pra pritjet për t'u transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele edhe 11 të tjerë (procedura të cilat janë në proces).

Në funksion të këtyre procedurave të lëvizjeve paralele, Këshilli me vendimet nr. 478-nr.480 vendosi transferimin e përkohshëm me pëlqim në këtë gjykatë edhe të 3 (tre) gjyqtarëve, efektet juridike të të cilave kanë filluar më datë 11.09.2024. Bëhet fjalë për

vendimet e fundit të muajit korrik ku ne kemi transferuar përkohësisht në Gjykatën e Tiranës edhe tre gjyqtarë (janë zonja {...}, zoti {...} dhe zonja {...}). I kemi transferuar në Gjykatën e Tiranës sepse ne konsiderojmë që ata janë kandidatë potencialë për të fituar në pozicionet për të cilat ata kanë kandiduar, pasi janë me dy vlerësime në pozicionet e tyre.

Ngarkesa e gjykatës për 3-mujorin e dytë të vitit 2024 sipas tabelës së mëposhtme, është e integruar dhe s'po e lexoj një nga një. Do shikoni edhe ngarkesën e gjyqtarëve për çështje të mbartura nga vitet e mëparshme për secilin prej tyre. Çështjet e regjistruara nga data 1 janar i vitit 2024. Çështjet që kanë në gjykim të papërfunduara si dhe çështjet e përfunduara të gjykuara nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Mund t'ju them që totali i çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme deri tani në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në total janë 19,938. Numri i çështjeve të regjistruara të reja janë 17,729 (pra rritet në progresion edhe numri i çështjeve të regjistruara). Numri i çështjeve të gjykuara janë 17,384 çështje. Numri i çështjeve në gjykim janë 19,938 (afërsisht 20,000 çështje në gjykim).

Nga të dhënat e përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë e juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vihet re ngarkesa në dhomën civile e cila varion nga 1,887 çështje për gjyqtar, në 116 çështje të tilla; ndërsa në dhomën penale nga 367 çështje për gjyqtar, në 16 të tilla; ngarkesa mesatare në dhomën civile është 578 çështje/gjyqtar; në seksionin familjar të dhomës civile është 365 çështje/gjyqtar; ndërsa në dhomën penale është 214 çështje/gjyqtar. Shikoj që ka një rritje të numrit të çështjeve të gjyqtarëve të dhomës penale të Gjykatës së Tiranës. Pra po shkon 214 çështje për secilin gjyqtar.

Sipas të dhënave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, si edhe ato të përcjella nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, rezulton se nga seksioni penal janë këto vakanca të përhershme, ose që priten të bëhen të përhershme brenda 3 muajve: Janë larguar aktualisht 2 (dy) gjyqtarë (z. {...} është gjyqtar i cili është larguar me ngritje në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO) si dhe z. {...} i cili së fundmi ka marrë një vendim shkarkimi nga KPA).

Gjithashtu pritet të ngrihet në detyrë minimalisht 1 gjyqtar nga kjo gjykatë në pozicionet e GJKKO-së, ku konkurrojnë gjyqtarë të seksionit penal, ka edhe 1 gjyqtar të pezulluar për shkak të një procedimi penal duke rritur edhe ngarkesën në këtë seksion (pra ngarkesën e dhomës penale). Rezulton se nga 13 pozicione për lëvizje paralele të cilat ne i kemi hapur dhe i kemi në proces verifikimi, vetëm 3 (tre) i përkasin seksionit penal (pra nga 13 pozicione që ne i kemi në proces dhe do t'i lëvizim nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele, vetëm tre prej tyre janë në seksionin penal, të hapura si vende të lira) ndërsa 10 (dhjetë) të tjera do të jenë në seksionin civil. Duke marrë parasysh situatën aktuale dhe atë të pritshme, ne propozojmë të shpallim më tepër pozicione për dhomën penale, pra seksionin penal se në atë civil. I tregova arsyet, Janë hequr më tepër nga seksioni penal. Trendi është në rritje në seksionin penal të çështjeve që ka në gjykim Gjykata e Tiranës si dhe pritshmëritë tona për të stabilizuar gjendjen e seksionit civil në Gjykatën e Tiranës është e mirë si pritshmëri për sa kohë që janë në pritje për t'u transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele 10 gjyqtarë që janë në proces të procedurës së lëvizjes paralele për seksionin civil në Gjykatën e Tiranës.

Vakancat që janë të përhershme ose që priten të bëhen të përhershme brenda 3 muajve në seksionin civil rezulton se: pozicione vakante në seksionin civil janë ato të ngritjes në detyrë (që ne kemi çuar gjyqtaren znj. {...} në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) pra do lirohet një vakancë brenda muajit shtator si dhe pozicioni tjetër vakant i seksionit civil i referohet vendimit që ka marrë Kolegji i Posaçëm i Apelimit ndaj gjyqtarës {...}. Kështu që janë dy pozicione të lira të përhershme në seksionin civil në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndodhur në këto kushte, që ta përmbledh edhe pjesën tjetër, nuk po zgjatëm shumë, janë të shënuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; dhe ne propozojmë Këshillit që të hapet procedura për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira, në fushën e së drejtës civile dy të tilla, dhe në fushën e së drejtës penale tre pozicione të

lira. Bashkëlidhur janë edhe projektvendimet përkatëse që i referohen këtij relacioni që unë e bëra prezent përpara Këshillit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, lidhur me afatin z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Atëherë, qëllimisht nuk e kemi prezantuar në projektvendim afatin, nuk e kemi vënë vetë ne si Komision, por i propozojmë Këshillit që afati të jetë më i vogël sesa ai i parashikuar në ligj. Ligji thotë brenda dy javëve minimumi. Ne propozojmë që afati të jetë 1 javë. Afati për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi nga kandidatët të jetë 1 javë dhe këtë propozim e shoqërojmë edhe me një propozim tjetër, që secilin kandidat të gjykatës së shkallës së parë, të të gjithë juridiksioneve të përgjithshme, t'i dërgohet nominalisht në rrugë elektronike projektvendimi, me qëllim që ata të shprehin interesin e tyre për të kandiduar në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Propozimin për afatin afërsisht njëjavor ne e bëjmë duke e lidhur këtë situatë edhe me situatën e caktimit tashmë në pozicione të magjistratëve që ne i kemi emëruar (që kanë mbaruar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës), që janë gjithsej 32 magjistratë. Hapja e këtyre vendeve dhe konkurrimi në këto vende për kandidatët në detyrë që do konkurrojnë në lëvizjen paralele, do na krijojë mundësinë që ne shumë shpejt brenda këtij muaji të dalim me propozimin e ri për përcaktimin e pozicioneve të përhershme për gjyqtarët magjistratë të cilët do caktohen në pozicion pasi kanë përfunduar vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës. Pra kjo është arsyeja pse unë propozoj, Komisioni ynë propozon që afati i depozitimit të kërkesave për shprehje interesi të jetë 1 javë, duke njoftuar nominalisht secilin prej kandidatëve në adresën zyrtare elektronike të tyre. Faleminderit! Pra afati i kandidimit është data 20.09.2024, si sot java.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Nga ana e administratës të merren masat që të informohen individualisht të gjithë gjyqtarët për e-mailin që do marrin. Dhe kjo duhet të bëhet nga administrata me një telefon. Çojini e-mailin dhe thuajini: -Ju ka ardhur një email nga Këshilli. E keni marrë? Sepse për efekt efektiviteti duhet të reagojmë sa më shpejt. Ok?

(Flet z. Kurushi pa mikrofon.)

Naureda Llagami: ...që secili e ka marrë, se e vlerësojnë ato, është problemi i atyre. Ne të marrim masat tona.

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele për 5 pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dy pozicione në fushën e së drejtës civile dhe tre pozicione në fushën e së drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 20 shtator 2024.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, relatores znj. Emona Muçi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 8. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, relatores znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Kemi aktin e dytë që ka të bëjë me miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Muçi.

Emona Muçi: Atëherë, shkurtimisht në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar” rezultoi se më datë 22.08.2024,

është protokolluar pranë Këshillit kërkesa e magjstrates me objekt dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për periudhën 28.09.2024 deri në datën 20.12.2024.

Në kërkesën me shkrim gjyqtarja parashtron se, në datën 03.10.2023 ka përfituar nga leja e paralindjes dhe aktualisht është me raport për barrëlindje. Duke pasur parasysh që leja e barrëlindjes jepet për një afat maksimal prej 12 muaj, duke përfshirë edhe paralindjen, atëherë koha që ajo duhet të paraqitet në punë sipas llogaritjeve të saj është data 28 shtator 2024 (me një e-mail të mëvonshëm gjyqtarja magjistratë ka saktësuar që data do të ishte data 25 shtator 2024) kohë kur fëmija i saj është ende 11 muajsh dhe ushqehet me gji. Për këtë arsye, për shkak të një pamundësie për shkëputje fizike, qoftë edhe për pak çaste më shumë për të ndenjur me fëmijën, ka kërkuar edhe një kohë tjetër dhe konkretisht deri në datën 20.12.2024.

Duke marrë dhe duke vlerësuar kërkesën e saj, nga ana e Komisionit është analizuar në lidhje me të.

Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, parashikuar nga neni 24 i ligjit dhe vendimi nr. 72, 20.05.2019, janë parashikuar:

- a. Lejet prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore.

Duke parashikuar këto leje, janë parashikuar edhe kriteret e tyre.

Bazuar në rrethanat faktike e kuadrin ligjor e sipërcituar, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se për aplikimin e kësaj të drejte ndaj magjstratit (gjyqtar) duhet të plotësohen disa kushte të natyrës formale dhe materiale:

Kushtet formale lidhen me detyrimin për paraqitjen e kërkesës për leje prindërore në formën dhe afatin e duhur. Këto kriteret rezultojnë se janë respektuar.

Në lidhje me kushtet materiale lidhen me detyrimin që kërkuar të ketë ushtruar funksionin për më shumë sesa një vit të pandërprerë dhe kërkesa e saj të mos cenojë funksionalitetin e gjykatës. Lidhur me këto kushte, Komisioni vlerëson se plotësohen, pasi: Gjyqtarja ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë; Në kërkesën

e gjyqtares është paraqitur dokumentacioni justifikues, nëpërmjet postës elektronike, më datë 20.08.2024; Gjyqtarja ka në ngarkim një fëmijë të mitur më pak se 6 vjeç. Nga certifikata familjare, rezulton se fëmija i mitur ka lindur në datën 31.10.2023, pra ky kusht plotësohet.

Sa i përket kushteve materiale të kërkesës, janë thelbësore për pranueshmërinë në themel të saj.

Afatit ligjor për lejen në si Komision i jemi referuar si ligjit për statusin që parashikon lejen prindërore, direktivave si dhe të drejtës së përfitimit të lejes prindërore që parashikon Kodi i Punës dhe kemi vlerësuar se Kodi i Punës ka vendosur kufij minimal, por jo atë maksimal të kohëzgjatjes së lejes prindërore për gjyqtarin, duke sanksionuar parimin se: “Kohëzgjatja e lejes prindërore përcaktohet me marrëveshje me shkrim mes punëdhënësit e punëmarrësit”. Bazuar në këtë parashikim ligjor Këshilli në pikën 5 të vendimit nr. 72, 20.05.2019, ka parashikuar se leja prindërore i jepet gjyqtarit për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se 2 vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim, të arrijë moshën 6 vjeç.

Ndarja e lejes prindërore sikundër edhe shtyrja e datës së fillimit të saj, në referim të nenit 132/1 të Kodit të Punës, kërkojnë marrëveshje me shkrim midis punëdhënësit e punëmarrësit. Komisioni vlerëson se në këtë rast, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund të refuzohet.

Dhe në përfundim, propozimi i Komisionit është miratimi i kërkesës së zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për dhënie leje prindërore për periudhën nga data 25 shtator - kjo pas edhe saktësimit të bërë me e-mailin pasi Komisioni e ka kaluar mbledhjes plenare; nga ana e Komisionit është shpërndarë e-maili të gjithë anëtarëve përpara kësaj mbledhjeje, duke saktësuar datën jo 28 por 25 shtator - deri në datën 20 dhjetor 2024.

Njoftimi i këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimit, do të hyjë në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit sipas nenit 98, pika 2 të ligjit nr. 115/2016.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për dhënie leje të papaguar prindërore për periudhën nga data 28 shtator deri në 20 dhjetor 2024.

2. Njoftimi i këtij vendimi gjyqtarës znj. {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë)...

25 dhjetor! (*Bëhet fjalë për periudhën e cila u referua nga relatorja zonja Muçi pak më lart, që periudha do të jetë 25 shtator deri në 20 dhjetor*).

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit....

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në numrin e pozicioneve të punës në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm Berat, Fier dhe Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Bledar Bajri* (anëtar)
8. *Albens Tabaku* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në numrin e pozicioneve të punës në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm Berat, Fier dhe Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Tani, kalojmë tek akti tjetër që do raportohet në fakt nga Drejtorja e Departamentit të Burimeve Njerëzore.

Ky është një akt që ka kaluar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Në fakt bëhet fjalë për një kërkesë që na ka ardhur, që çuditërisht pse nuk e kemi kërkesën bashkëlidhur këtu të Gjykatës së Lartë, Etrita?

E keni ju tek aktet?

Etrita pse s'e kemi kërkesën këtu?

Ia ke përcjellë Drejtorisë Juridike?

(Rezulton që shkresa nuk është përcjellë tek anëtarët e Këshillit si material që shoqëron aktin.)

Herë tjetër të mos përsëritet më.

Shko merre shkresën, hajde këtu!

Sille këtu për të gjithë anëtarët!

Kalojmë tek aktet e tjera, sa të na vijë shkresa, sepse ju duhet të viheni në dijeni me shkresën e gjykatës e cila ka sjellë, por drejtoresha nuk e vlerëson.

(Ndërkohë që shumëfishohet për anëtarët e Këshilli materiali shoqërues i kërkuar sa më sipër, kjo çështje lihet përgjysmë dhe për efektivitet, vijohet me çështjet e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor për znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, përkatësisht pikat e rendit të ditës me numër rendor 7 – 10. Pas trajtimit të këtyre katër çështjeve, dhe pasi anëtarëve u është vënë në dispozicion shkresa e lartpërmendur, vijohet me çështjen në fjalë si më poshtë.)

Naureda Llagami: Tani kalojmë tek projekt-akti tjetër, pasi Drejtoresha solli shkresën nga ana e Gjykatës së Lartë.

Shkurtimisht Gjykata e Lartë ka kërkuar Këshillit nevojën për një shtim organike, me sekretari gjyqësore, me të paktën tre sekretare gjyqësore, e cila kërkon plotësimin e nevojave të trupës gjyqësore. Ashtu sikurse shprehet në shkresë, gjykata ka një urgjencë të madhe për shkak të ngarkesës, për shkak edhe të mangësive që ka në plotësimin e njësisë ligjore, pasi mungojnë ndihmësit ligjorë dhe që për këtë arsye ato kanë

parashtruar që kërkojnë tre sekretarë (tre pozicione në shtim strukture), duke iu përgjigjur edhe tashmë numrit të plotë të trupës gjyqësore.

Në fakt, nga ana e Komisionit tonë kemi bërë një vlerësim total të numrave dhe pozicioneve që kemi vakanca në sistem. Duhet ta pranojmë dhe unë e kam thënë edhe publikisht dhe do vazhdoj ta them që gjykatat duhet të jenë të afta të rekrutojnë (të mos lejnë vakanca) sepse kjo pengon edhe në përthithjen e numrave dhe nga ana e qeverisë. Duke parë ecurinë e vakancave që kemi, atëherë ne kemi propozuar marrjen e disa vendeve vakante në ato gjykata që shihet që nuk kanë ecuri në rekrutim, edhe që stafi që është, i mbulon nevojat me trupën gjyqësore edhe sikur ta mbushim trupën gjyqësore. Kështu që për këtë arsye..., për t'ia dhënë Gjykatës së Lartë si një rast emergjent meqenëse ato kanë nevojë dhe me numrat e rinj që ne marrim me buxhetin e 2024, edhe këto numra që ia kemi marrë atyre gjykatave ne ia plotësojmë në janar. Por ato kanë prapë vakanca, kështu që nuk krijojmë një mosfunksionim të burimeve njerëzore në ato gjykata që ne kemi propozuar marrjen e numrave.

Drejtoreshën e keni këtu.

Po deshët ndonjë pyetje ekstra, përveç relacionit. Pa diskutim që ajo mund t'jua ofrojë përgjigjen.

Sa është numri total? 60 e ca është numri i të gjithë vakancave në sistem?

Aktualisht të pashpallura.

(Përgjigjet zonja Petriti, pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: E kuptoni?

Që të kuptoni, që kur flasim për burime, dhe unë kur shkoj në Kuvend dhe flas për burime njerëzore, dhe themi s'ka burime njerëzore, duhet të kuptojmë, të paktën për stafin administrativ, që gjykatat duhet të përthithin sa më shumë vakancat, në mënyrë që ne të legjitimohemi për të thënë... (kur flasim për stafin administrativ, se vakancat e gjyqtarëve është gjë tjetër).

Klodian Kurushi: Në këtë drejtim mund të bëjmë një çik më tepër neve?

Naureda Llagami: Atë që unë propozoj dhe është besoj në një plan që ne duhet ta vendosim të gjithë bashkë, ajo që ne konstatojmë është tek këshillat e gjykatave, pra konstatojmë që me këshillat e gjykatave ndoshta edhe për shkak të ndryshimeve të shpeshta që i ndodh zëvendëskryetarit, lëvizjet që kemi pasur. Sa vjen zëvendëskryetari i ri, ka një lloj vonese në pjesën e administrimit. Se në gjykatat që kanë një lloj qëndrueshmërie lidershipi, pa diskutim nuk i ka këto probleme. Ndoshta ka ardhur koha që, pse jo, duke marrë si pretekst edhe pjesën e shqetësimeve që kemi nga veprimtaria e këshillave të gjykatave, ndoshta të bëjmë edhe një tur - ne e kemi lënë këtë bashkë me ju në qershor - por unë them ka ardhur koha që ne të dalim në një tur gjykatash ku ne të diskutojmë çështjet prioritare që janë (një) problematikat që na vijnë nga drejtimi i këshillave të gjykatave; (dy) diskutimi i normës që e kemi edhe në Rezolutën e Kuvendit, që është diçka prioritare për ne tashmë, që duhet të dalim dhe ta diskutojmë; dhe unë do propozoja, bashkë me ju, ndoshta javën tjetër, të bëjmë një kalendar lëvizjesh dhe të shkojmë... dhe në këtë lloj mënyre ne edhe marrim problematikat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nga ana tjetër edhe ndajmë shqetësimet duke marrë parasysh edhe situatat sporadike që kemi pasur me dy-tre këshilla gjykatash.

Kështu që, nëse unë kam dakordësinë tuaj, bëjmë një kalendar dhe ndoshta një herë në javë, një grup i përbërë me gjyqtarë dhe jogjyqtarë, lëvizni për të parë këtë gjë, dhe pse jo, edhe për të diskutuar normën. Ky do të ishte një propozim që e kemi thënë bashkë në qershor, por që në qershor e lamë pak si “pending”. Kështu që kjo është situata dhe kjo është arsyeja pse po ia marrim Gjykatës së Lartë, por gjithmonë me rezervën që në janar ne prapë do ia plotësojmë këtyre, por për momentin Gjykata e Lartë ka një nevojë imediate.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Fier dhe Tiranë, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të njoftimit të gjykatave respektive, referuar këtij vendimi.

Pra i kemi marrë një pozicion Gjykatës së Beratit, Fierit dhe Gjykatës së Tiranës, për t'ia dhënë Gjykatës së Lartë në këto momente, duke qenë se ato kanë akoma pozicione të lira aty.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatores znj. Gentiana Muçaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Bledar Bajri** (anëtar)
8. **Albens Tabaku** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
12. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
13. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtim i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Naureda Llagami: Kalojmë, janë 5 akte individuale të kaluara nga Komisioni.

4 janë? Me gjithë {...}?

Po, 4 pra. (*Ripërsëritet*).

Pra procedura që bën Këshilli në këtë rast është një procedurë thjesht konfirmimi në pranimin në shërbimin gjyqësor civil. Kështu që për më shumë detaje.

Atëherë fjalën ia jap relatores znj. Gentiana Muçaj e cila do t'i relatojë të katër aktet.

Gentiana Muçaj: Faleminderit Kryetare!

Zonja {...} ushtron detyrën e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit. Është emëruar me Urdhrin nr. {...} prot., datë 05.06.2015 të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në këtë detyrë, të cilën vijon ta ushtrojë aktualisht.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me miratimin e vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 ka patur si qëllim përcaktimin e rregullave më të hollësishme mbi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor.

Rezulton që zonja {...} i është nënshtruar procesit të verifikimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe me vendimin nr. 770, datë 31.05.2024, në përfundim të procedurës ky Komision ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...} si ndihmës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 27.06.2024. Sa më sipër zonja {...}, në respektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 130, të vendimit të Këshillit nr. 424/2020, ka depozituar kërkesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit.

Rezulton se kjo kërkesë është depozituar më datë 24.07.2024, në të cilën shprehet interesi nga znj. {...}, për emërim si ndihmës Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Për sa i përket rezultateve të verifikimit, rezulton që efektet juridike të filluara më datë 10.06.2015 ku znj. {...} është emëruar si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit zgjasin deri në përfundim të procedurës së verifikimit.

Bazuar në rezultatet e vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 770 datë 31.05.2024, në përfundim të procedurës së verifikimit të subjektit të rivlerësimit kalimtar znj. {...} ka konkluduar, duke vendosur përfundimisht mbi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Ndërkohë, kur verifikimi i pasurisë dhe i figurës, konsiderohet i përmbushur, referuar vendimit nr. 770 datë 31.05.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi konfirmimin në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, rezulton se znj. {...} i është nënshtruar tashmë verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, proces të cilin e ka kaluar me sukses dhe duhet të pranohet në shërbimin civil gjyqësor.

Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për ndihmës ligjor, ligji “Për pushtetin gjyqësor” parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimin civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmës ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji ka parashikuar në pikën 2, të nenit 56 të tij, që janë: “2. ...: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira... etj.”.

Sa më sipër, lidhur me plotësimin e kritereve të pranimit në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, konstatohet fakti se ajo i përmbush të dyja këto kriteret, bazuar në të dhënat që disponon Këshilli në dosjen personale të saj, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Kur kërkesa e zonjës {...} është depozituar më datë 24.07.2024, në të cilën shprehet interesi për emërim si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit,

Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin në pozicion, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish gjyqësorë, pasi kreu verifikimin që ajo i përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion.

Për këtë qëllim, u verifikua organika e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, lidhur me organizimin dhe numrin e ndihmësve ligjorë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Nga informacioni i përcjellë në rrugë elektronike më datë 25.07.2024, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, referuar të dhënave mbi Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, rezulton se njësia është e përbërë nga 13 (trembëdhjetë) pozicione sipas strukturës organizative, 9 (nëntë) pozicione sipas organikës në fakt, përfshirë dhe znj. {...} dhe 4 (katër) pozicione vakante. Pra konstatohet se ka pozicione të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, në dispozicion të kandidatëve për ndihmës ligjorë.

Sa më sipër znj. {...}, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, në kushtet kur ajo është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të saj aktual për të cilin përmbush kriteret, si dhe kur aktualisht ushtron funksionin pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

Dhe Komisioni i Strategjisë propozon pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Pra Genta, se pak a shumë fabula është e njëjtë për të gjithë. Ti kalo vetëm tek vendimet.

Kalojmë të parën sepse të gjithë janë me vendim të formës së prerë. Lexojmë vetëm projekt-aktet. E njëjta gjë është.

Unë them kalojmë {...}n tani dhe na thuaj më pas vetëm aktin, vendimin e Këshillit për secilin.

Pra kalojmë në miratimin e projekt-aktit për {...} sipas propozimit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit.

Pranimi në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimi në pozicionin e “ndihmësit ligjor” në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Bledar Bajri*** (anëtar)
- 8. Albens Tabaku*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
12. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
13. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tani me zonjën {...}. Edhe kjo është në të njëjtën situatë me zonjën {...}.

Gentiana Muçaj: Edhe {...} është në të njëjtën situatë me zonjën {...}. Janë të njëjtat parashikime ligjore, të njëjtat kushte. Ka kaluar procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë. Ushtron detyrën në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kështu që propozoj pranimin në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kemi pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimi në pozicionin e “ndihmësit ligjor” në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatores znj. Gentiana Muçaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Bledar Bajri** (anëtar)
8. **Albens Tabaku** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
12. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
13. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër që është për zonjën {...}, në të njëjtën situatë.

Gentiana Muçaj: Edhe {...} është në të njëjtën situatë.

Kështu që propozoj pranimin në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim projekt-aktin?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: E njëjta situatë. Dakord Albensi.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli vendosi, pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimi në pozicionin e “ndihmësit ligjor” në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Bledar Bajri*** (anëtar)
- 8. Albens Tabaku*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
12. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
13. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relatore znj. Gentiana Muçaj.

Naureda Llagami: Kalojmë tek rasti tjetër, rasti i fundit në fakt për sa i përket ndihmësve ligjore, që është zonja {...}.

Gentiana Muçaj: Edhe për {...} e njëjta situatë.

Kështu që propozoj pranimin në shërbimin civil gjyqësor të zonjës {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim të projekt-aktit?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, pranimi në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimi në pozicionin e “ndihmësit ligjor” në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Tani kalojmë tek projekt-akti tjetër, pasi Drejtoresha solli shkresën nga ana e Gjykatës së Lartë. (*shih procesverbalin e pikës 6.*)

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Bledar Bajri** (anëtar)
- 8. Albens Tabaku** (anëtar)
- 9. Markelian Koça** (anëtar)

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, meqenëse kemi drejtoreshën këtu, unë do doja që të kalonim po nga ana e drejtoreshës, ndoshta jo tek rendi i ditës, tek miratimi i listës

56

përfundimtare për gjyqtarët që do marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor.

Ah, jemi me rendin.

Atëherë, siç jeni në dijeni, një pjesë e juaja, KLGJ-ja ka detyrimin një herë në katër vjet të zgjedhë me short, nga lista që miraton KLGJ-ja, anëtarët për Kolegjin Zgjedhor. Është një detyrim që na buron nga Kodi Zgjedhor. Ne hartojmë shortin (për të sqaruar edhe procedurën). Sot ne miratojmë listën.

Ditën e hënë unë paraprakisht doja që ta thoja, në orën 10:00 do bëjmë hedhjen e shortit dhe ditën e martë, po në orën 10:00 të bëjmë betimin e tyre, sepse janë procedura që kanë afate 24 orë e parashikon tek Kodi Zgjedhor, kështu që ne duhet të ecim shpejt.

Ju sjell në vëmendje që kolegëve aktual, pra anëtarëve aktual të Kolegjit Zgjedhor u ka mbaruar afati i tyre më datë 9 shtator, kështu që për këtë arsye ishte urgjenca e miratimit të këtij akti.

Për më shumë detaje se çfarë parashikon Kodi Zgjedhor, kush janë kriteret për kandidatët, për gjyqtarët që duhet të jenë pjesë e listës zgjedhore, do ia jap fjalën drejtoreshës.

Etrita Petriti: Të nderuar, faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin 293, datë 09.09.2020 “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, i ndryshuar, ka miratuar zgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me përbërje si vijon:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...};
5. Znj. {...};
6. Znj. {...}
7. Znj. {...};
8. Znj. {...}.

Sipas përcaktimeve të nenit 146 të ligjit nr. 10019/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor për përzgjedhjen me short të anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Duke iu referuar pikës 1 të nenit të sipërcituar ky kolegji përbëhet nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me short nga radhët e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit. Nga shorti përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

Sa më lart, Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka përgatitur informacionin lidhur me gjyqtarët që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, nga gjykatat e sipërcituara.

Kjo listë është hartuar duke pasur në konsideratë edhe parashikimet ligjore të nenit 146 dhe 148 të Kodit Zgjedhor. Sipas Nenit 148 “1. Nuk përfshihen në shortin e hedhur, sipas nenit 146 të këtij Kodi, gjyqtarët, ndaj të cilëve:

- a) është vendosur fillimi i çështjes penale;
- b) është në fuqi një masë disiplinore;
- c) është filluar procedim disiplinor, si dhe
- d) gjyqtarët në detyrë të Kolegjit Zgjedhor.

Sipas informacionit të përcjellë pranë jush, në listën e paraqitur nuk ka gjyqtarë ndaj të cilëve: a) është vendosur fillimi i çështjes penale; b) ka masë disiplinore në fuqi; c) dhe filluar procedim disiplinor.

Lista përbëhet nga 95 (nëntëdhjetë e pesë) gjyqtarë të cilët plotësojnë kriteret ligjore:

- i) Gjyqtarët që kanë kaluar procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, me vendim të formës së prerë deri në datën e përfundimit të mandatit të anëtarëve aktual të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, domethënë deri në datë 09.09.2024.

ii) Nuk janë përfshirë gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar (me vendim të formës së prerë), referuar nenit 146/1.

iii) Këta gjyqtarë nuk kanë çështje në hetim. Gjyqtarët nuk kanë në fuqi një masë disiplinore, apo nuk është filluar procedim disiplinor, dhe nuk janë në detyrë në Kolegjin Zgjedhor miratuar me vendimin Nr. 293, datë 09.09.2020, të ndryshuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga lista fillestare me 116 magjistratë (gjyqtarë) janë përjashtuar 21 magjistratë (gjyqtarë) më konkretisht:

i) Gjyqtarët të cilët ndonëse kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, janë të komanduar me vendim të Këshillit dhe nuk janë aktualisht duke ushtruar funksionin e gjyqtarit.

ii) 5 (pesë) anëtarët e Këshillit nga radhët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

iii) 4 (katër) gjyqtarët ish-anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në konformitet me përcaktimet e Nenit 4 të Ligjit nr.115/2016 të ndryshuar, i cili parashikon se: “Anëtari gjyqtar, në përfundim të mandatit, kthehet në vendin e mëparshëm të punës. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose i gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtari gjyqtar i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë 3 viteve pas përfundimit të mandatit.”. Dhe nenit 146/3 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda 24 orësh nga hedhja e shortit, miraton me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor me një mandat 4-vjeçar. Përtëritja bëhet duke zbatuar procedurat dhe afatet e këtij ligji për përzgjedhjen, delegimin, betimin dhe konstituimin e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.”

Në dispozitën, pra nenin 146, pika 2 e saj, përcaktohet se shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hidhet jo më vonë se 48 orë nga data e përcaktimit të datës së zgjedhjeve më të afërta. Në të përcaktohet gjithashtu se shorti

hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

Rezulton se pas organizimit të shortit, sipas dispozitës 146, pika 3 e saj, Këshilli brenda 24 orësh nga hedhja e tij duhet të miratojë me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me një mandat prej 4 vjetësh.

Po duke iu referuar kësaj dispozite, pika 4, brenda 3 ditësh nga delegimi në detyrë, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor bëjnë betimin në një ceremoni publike, në prani të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur edhe lista emërore e 95 (nëntëdhjetë e pesë) gjyqtarëve të cilët plotësojnë kriteret ligjore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: E patë listën edhe një herë?

Nuk kemi diskutime.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni mbi listën? Nëse nuk kemi diskutime mbi listën, e miratojmë listën.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Të miratojë listën e gjyqtarëve të cilët përfshihen në shortin për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};
11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...};
16. {...};
17. {...};
18. {...};
19. {...};
20. {...};
21. {...};
22. {...};
23. {...};
24. {...};
25. {...};
26. {...};
27. {...};

28. {...};
29. {...};
30. {...};
31. {...};
32. {...};
33. {...};
34. {...};
35. {...};
36. {...};
37. {...};
38. {...};
39. {...};
40. {...};
41. {...};
42. {...};
43. {...};
44. {...};
45. {...};
46. {...};
47. {...};
48. {...};
49. {...};
50. {...};
51. {...};
52. {...};
53. {...};
54. {...};
55. {...};
56. {...};

57. {...};
58. {...};
59. {...};
60. {...};
61. {...};
62. {...};
63. {...};
64. {...};
65. {...};
66. {...};
67. {...};
68. {...};
69. {...};
70. {...};
71. {...};
72. {...};
73. {...};
74. {...};
75. {...};
76. {...};
77. {...};
78. {...};
79. {...};
80. {...};
81. {...};
82. {...};
83. {...};
84. {...};
85. {...};

86. {...};
87. {...};
88. {...};
89. {...};
90. {...};
91. {...};
92. {...};
93. {...};
94. {...};
95. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (datat 03.06.2024, 05.06.2024, 10.06.2024, 18.06.2024, 25.06.2024, 03.07.2024 (2), 09.07.2024, 11.07.2024, 24.07.2024).³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 8. Albens Tabaku | (anëtar) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
6. *Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
7. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
8. *Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
9. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Edmon Hoxhaj, BIRN.*
11. *Petrika Thanu, MCA-PRESS.*
12. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
13. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (datat 03.06.2024, 05.06.2024, 10.06.2024, 18.06.2024, 25.06.2024, 03.07.2024 (2), 09.07.2024, 11.07.2024, 24.07.2024).

Naureda Llagami: Kalojmë më pas. Jemi që jemi, kemi edhe aktin për miratimin e procesverbaleve, përpara se të kalojmë tek...

Kalojmë në miratim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord (nuk dëgjohej mirë).

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Emona Muçi. (ka kundërshtime).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
8. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

11. Emona Muçi

(anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Emona Muçi. (ka kundërshtime).

Naureda Llagami: Tani do bëjmë aktin tjetër që kemi për vlerësim.

Meqë gjyqtarja ka ardhur, unë propozoj që ne të kalojmë edhe atë dhe pastaj bëjmë pushim sepse është duke pritur gjyqtarja aty.

S’ka për të dytin por ne e kemi jashtë afateve, e fusim gjyqtaren e mbarojmë të dytin dhe pastaj e shqyrtojmë meqë jemi në procedurat tona.

69

Mendoj që duhet ta thërrasim atë tani dhe të vijojmë punën.

Thërrisni gjyqtaren këtu, se është ora 1 pa një çerek dhe nuk është e arsyeshme që të presi tre orë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Mirë se erdhe zonja {...}!

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor sot është marrë në shqyrtim dy projektraportet tuaja. Duke qenë se ju keni ardhur këtu me kundërshtime lidhur me projektraportin e dytë, procedura thotë që pasi ju të dëgjoni relatoren, ne jemi vënë nga relatorja informacioni, na janë vënë në dispozicion kundërshtime. Pasi relatorja shkurtimisht të bëjë prezantimin dhe gjetjet e raportit, më pas ju do bëni kundërshtimet tuaja, por ju lutem shkurtimisht, ato që ju keni përtej atyre që keni depozituar sepse Këshilli është vënë në dijeni tashmë me ato që ju keni depozituar brenda afateve ligjore. Më tej ju t'i parashtroni, dhe më pas do largoheni për t'i lënë Këshillit më pas procesin e vendimmarrjes.

Kështu që, pa humbur kohë ia jap fjalës zonjës Muçi.

Emona Muçi: Të nderuar!

Procedura e vlerësimit e gjyqtares {...} ka filluar me vendimin nr. 179, datë 03.04.2024. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relatore znj. Emona Muçi; Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj.

Në datën 04.04.2024, në bazë të neneve 85, pika 2 dhe 89, pika 3 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2022, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit janar–dhjetor 2022 (vlerësimi i përshpejtuar i detyruar), për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të

70

Këshillit. Në datën 05.04.2024, gjyqtarja {...}, nëpërmjet postës elektronike ka njoftuar marrjen e njoftimit, ka bashkëlidhur email-it deklaratën për adresën elektronike dhe kontaktet telefonike, si dhe gjatë këtij afati nuk ka parashtruar kërkesë për përjashtimin e vlerësuesit, ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

Me qëllim fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për gjyqtaren {...}, në referim të neneve 90 dhe 91 të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimit nr.263/2019, në datën 07.03.2024 është njoftuar Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për dërgimin e të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit 1 janar 2022 deri në datën 31 dhjetor 2022, pra përpara vendimit të kualifikimit, që në mars janë marrë masat.

Të dhënat statistikore janë dërguar nga gjykata me shkresën e datës 04.04.2024.

Në datën 05.04.2024, me shkresa të ndryshme i është kërkuar informacion Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës {...} gjatë periudhës së vlerësimit dhe Shkollës së Magjistraturës për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarës në veprimtaritë trajnuese. Me shkresën nr. {...} prot, datë 26.04.2024, protokolluar pranë Këshillit në datën 29.04.2024, ILD ka dërguar informacion lidhur me përfundimet e verifikimit të ankesave, ndërsa Shkolla e Magjistraturës ka kthyer përgjigje me shkresën e datës 11.04.2024, protokolluar pranë KLGJ-së po në datë 11.04.2024.

Në datën 09.04.2024, gjyqtarës {...} i është dërguar nëpërmjet postës elektronike njoftimi për plotësimin e “Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”, njoftim i cili i është dërguar edhe zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Pas plotësimit, formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarës i është dërguar në rrugë elektronike, si dhe nëpërmjet postës, protokolluar në datën 03.05.2024 në Këshill.

Pjesë e dosjes së vlerësimit, është bërë edhe kopja e aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, të dërguar nga ILDKPKI me shkresën e datës 14.06.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor në datën 20.06.2024.

Pas evidentimit të çështjeve me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtarja përtej afateve ligjore dhe standardeve minimale kohore, në datën 09.04.2024, është disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës për periudhën e vlerësimit janar–dhjetor 2022, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtarës, zv.kryetares dhe kancelarit të gjykatës.

Në datën 11.04.2024, është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, dokumentuar në procesverbalin përkatës. Gjyqtarja ka qenë prezent dhe nuk ka shfaqur pretendime në lidhje me procedurën e shortit.

Pas zhvillimit të shortit, me shkresën nr.{...} prot, datë 19.04.2024, protokolluar në KLGJ me shkresën me nr. {...} prot, datë 19.04.2024, është dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë 3 (tre) nga 6 (gjashtë) dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) dosjet e tjera të përzgjedhura me short janë dërguar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me shkresën e datës 19.04.2024.

Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, ka filluar nga nëpunësja përgjegjëse për vlerësim, hartimi i raportit analitik.

Në datën 28.06.2024, nga ana e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin është dorëzuar i përfunduar “Raporti analitik për vlerësimin etik dhe profesional” të magjistrates.

Me vendimin “Për plotësinë e procedurës dhe dokumentacionit të dosjes”, në datën 03.07.2024, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vendosur: “Vlerësimin e plotësisë së dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura për krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik për gjyqtaren {...}. Vijimin e procedurës së vlerësimit për hartimin e projektraportit të vlerësimit”.

Projektraporti vlerësimit i është njoftuar gjyqtarës në adresën e saj elektronike në datën 04.07.2024 dhe brenda afatit njëjavor, në datën 11.07.2024 gjyqtarja depozitoi kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit. Konkretisht, gjyqtarja paraqiti

kundërshtime lidhur me kriterin e “Aftësive Organizative”, duke kundërshtuar treguesit “Respektimi i afateve ligjore” dhe “Koha mesatare e arsytimit të vendimit”, në mbështetje të të cilave gjyqtarja paraqiti si prova:

(i) Listat e shorteve të datave 30.09.2022, 28.09.2022, 10.10.2022, 14.11.2022, 13.04.2022, 23.05.2022;

(ii) Printime nga sistemi lidhur me çështjet me numër akti 15318, 15217, 15440, 16291, 486, 654, 12791, 11988, 388, 959, 11803, 11917, 12144, 12280;

(iii) Vendimin nr. 896, (të mos lexoj numrin e sistemit), datë 20.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit është pasqyruar në mënyrë të plotë në projektraportin e vlerësimit, dhe për të mos u zgjatuar, vlerësoj të ndalem shkurtimisht në disa konkluzione.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta për të identifikuar konfliktin e normave juridike, jo vetëm të një karakteri të brendshëm, por edhe kur ato janë norma të një niveli të ndryshëm hierarkie. Për këtë arsye në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet dhe pikëzohet me 25 pikë.

Në lidhje me 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuara, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me 1.B.a Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmëria e vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Në lidhje me 1.B.b Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se

aftësia e gjyqtares në këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Në lidhje me 1.B.c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Në këtë kontekst vlerësohet një shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtares për të identifikuar marrëdhënien shkak-pasojë dhe zbatimin e dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Në tërësi në vendimet e vëzhguara gjyqtarja e shoqëron analizën e saj juridike me praktikën gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë duke marrë në analizë të gjitha pretendimet dhe kërkimeve të palëve gjyqësore, në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në përfundim, në lidhje me nivelin e vlerësimit për Kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në lidhje me kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën.

Në lidhje me 2.A.a Respektimin e afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit 2022, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar në total 92 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor, nga të cilat 83 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor. Pra kjo është pjesa që rezulton nga statistikat dhe i përkon një përqindjeje 90% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, zëvendëskryetari i gjykatës në mendimin e tij e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të këtij treguesi si “Shumë të lartë”. Po kështu, edhe gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “Shumë të lartë”, duke parashtruar se është përpjekur maksimalisht të respektojë afatet e parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive, por

gjithmonë duke u kujdesur që kjo të mos cenojë kontradiktoritetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor. Respektimi i afateve ligjore për vitin 2022 në disa raste ka qenë i pamundur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i gjyqtarës.

Gjithashtu, gjyqtarja ka parashtruar disa shkaqe që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve me afat ligjor dhe konkretisht në aktin e paraqitur prej saj:

i) Organika jo e plotë e gjyqtarëve (nga 37 gjyqtarë që kishte seksioni civil e tregtar në vitin 2017, në vitin 2022 ky seksion kishte 17 gjyqtarë) e bën të pamundur respektimin e të gjithave afateve procedurale të caktuara nga ligji për të përfunduar gjykimi i një çështje, pasi për shkak të ngarkesës për një çështje civile zhvillohen tre seanca në një vit kalendarik (bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur pjesë nga analiza e gjykatës të vitit 2017 dhe vitit 2022).

ii) Rritja e ngarkesës së punës përgjatë viteve 2019-2022 për shkak të rishpërndarjes me short të dosjeve të gjyqtarëve të pezulluar ose të shkarkuar nga procedura e Vetting-ut (bashkëngjitur formularit gjyqtarja ka paraqitur urdhrat e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të Gjykatës).

iii) Në rastin e kërkesave me objekt “Sigurim padie” ato janë vënë në lëvizje brenda 5-ditëve, por përfundimi i tyre përtej këtij afati ligjor ka ndodhur për shkaqe objektive dhe që lidhen me njoftimin e palëve ndërgjyqëse kur shqyrtimi i tyre bëhet në seancë, respektimin e parimit të kontradiktoritetit apo kërkesat për shtyrje të seancës nga palët ndërgjyqëse për arsye objektive.

iv) Në rastin e kërkesave për regjistrimin e OJF në disa raste kërkesat janë lënë me të meta, duke njoftuar palën për plotësimin e tyre. Gjithashtu, kohë kërkon edhe administrimi i praktikës në Zyrën e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse, ku në disa raste kjo praktikë ndodhet në gjykatën e apelit, pasi mund të jetë ankimuar një vendim i mëparshëm.

v) Në lidhje me shqyrtimin e ankimeve me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore” në disa raste ka qenë e nevojshme kryerja e seancës dëgjimore për të thirrur dhe dëgjuar palët ndërgjyqëse, apo në disa raste gjykata ka thirrur si person të

interesuar në proces edhe kreditorin. Po kështu në ankimet kundër veprimit përmbarrimor të përcaktimit të vlerës së sendit, detyrimisht është zhvilluar seancë gjyqësore dëgjimore për të realizuar aktin e ekspertimit. Në disa raste ankimet kundër veprimeve përmbarrimore kanë qenë me të meta dhe u është lënë koha për të plotësuar të metat e ankimit. Gjithashtu, konstatohet se disa ankime kundër veprimeve përmbarrimore janë rishortuar nga gjyqtarë të tjerë dhe këtë të fundit nuk kanë mundur të gjykojnë brenda afatit 20-ditor sikurse e parashikon ligji.

Këto ishin pretendimet e gjyqtarës të cilat janë marrë në analizë së bashku me statistikat nga ana e relatores dhe duke interpretuar në lidhje me afatin e gjykimit neni 610 i cili parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi dhe kur vlerësohet e arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e një afati të arsyeshëm për plotësimin e të metave, sipas parashikimeve të nenit 154/a të K.Pr.Civile;

- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbarruesit gjyqësor dhe lënien e një afati të arsyeshëm për të paraqitur aktet e dosjes përmbarrimore (nëse ato nuk janë paraqitur të plota nga ankuesi) dhe për të parashtruar qëndrimin e tij lidhur me ankimin;

- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t'u dëgjuar.

Nga ana e relatores është mbajtur në vëmendje se vetëm duke u kryer këto veprime minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe për të mundësuar kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me çështjen, pa përlllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbarruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20-ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar.

Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë ka parashikuar një afat 20-ditor, për gjykatën e apelit ka parashikuar një afat më të gjatë 30 dhe 45 ditë, dhe në rast se gjykata do të vlerësonte të nevojshme shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji, do të zbatohet afati i dytë, pra 45 ditorëshi. Nëse për gjykimin në shkallë të parë do të zbatohet i njëjti afat, pra do të ishte afati 30 ditë për shqyrtimin në dhomë këshillimi dhe 45 ditë në seancë, rezulton se për 6 (gjashtë) nga çështjet që rezultojnë të përfunduara jashtë afatit ligjor, nuk do të ishte tejkualuar ky afat pasi ato kanë përfunduar respektivisht për 23, 33, 31, 45, 44 dhe 27 ditë. Për këto arsye, ngas ana jonë, këto gjashtë çështje përlllogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.

Në çështjet me objekt “Ndihmë juridike dytësore” apo “Përrjashtim nga taksat gjyqësore”, nga 13 çështje, rezultojnë se... domethënë të gjitha janë shqyrtuar jashtë afatit 15-ditor, që kanë përfunduar për 57, 51, 92 ditë, sipas gjetjeve. Ndërkohë rezulton se çështjet me numër rendor 461 dhe 464, kanë përfunduar respektivisht për 8 dhe 6 ditë. Duke tejkualuar afatin ligjor me 3 dhe 1 ditë, tejkalime të cilat vlerësohen të papërfillshme, dhe gjithashtu edhe këto dy çështje përlllogariten nga ana jonë si çështje të cilat janë gjykuar brenda afatit ligjor.

Në lidhje me çështjet me objekt “Regjistrim” apo “Depozitim aktesh”, nga 51 çështje, rezultojnë 47 prej tyre të gjykuara jashtë afatit 15-ditor, të cilat kanë përfunduar respektivisht... - i kam shënuar në raport ditët.

Ndërkohë që evidentohet se çështjet me numër rendor 7, 8, 9 dhe 15, kanë përfunduar respektivisht për 21 ditë, 21 ditë, 17 ditë dhe 18 ditë, duke e tejkualuar afatin ligjor me 6 ditë, 2 ditë apo 3 ditë. Tejkalime këto që vlerësohen të pakonsiderueshme për vetë ngarkesën e punës dhe si rrjedhim, edhe këto katër çështje janë konsideruar nga ana ime si të gjykuara brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj.

Për sa më sipër, nga numri i përgjithshëm që rezultonte prej 83 çështje jashtë afateve ligjore, rezultojnë që janë vetëm 71 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim, pra 71 dhe

numrit total 92 çështje, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 77% të çështjeve tej afatit ligjor.

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas metodologjisë pikëzohet me 3 pikë. Në metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjes në periudhën e vlerësimit prej 2,467 çështjesh, nga të cilat 1,366 të mbartura nga viti 2021 dhe 1,101 të regjistruara në vitin 2022, si dhe ka përfunduar 706 çështje. Ngarkesa e lartë parashtruar nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, si shkak për pamundësinë e respektimit të afateve të gjykimit është një e dhënë e cila mbështetet edhe nga të tabelat me të dhëna statistikore të administruara si burim vlerësimi.

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por nga një analizë logjike e të dhënave burimore. Për pikëzimin në rastin konkret mbahet në konsideratë:

- i) ngarkesa e lartë të gjyqtares;
- ii) mendimi i kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) numrin jo të lartë të çështjeve me afat ligjor, 92 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 13% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit;
- iv) rritja e papritur të volumit të punës në muajt prill, korrik dhe tetor 2022 për shkak të rishortimeve si efekt i procesit të vettingut;

Në projektraportin e vlerësimit për këtë tregues, është propozuar që gjyqtarja të pikëzohet dy nivele më lart se pikëzimi që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja rezulton 77%.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka pasur kundërshtimet e saj, ka kërkuar pikëzimin maksimal me 15 pikë, dhe ka parashtruar:

Për sa i përket kërkesave për sigurim padie - Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2022, ka pasur si praktikë pune që çështja e cila paraqitet nga pala në gjykatë, nuk shortohej menjëherë në ditën që paraqitet padia së bashku me kërkesën për sigurimin e padisë, ankimi kundër veprimeve përmbarimore, apo kërkesa për sigurim padie, por shortohej më vonë. Pas shortimit merrej në dorëzim nga gjyqtari në një ditë tjetër dhe më tej vijonte gjyqtari me veprimet e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi gjyqtarja ka paraqitur printimet nga sistemi elektronik për të treguar datën e shortimit të çështjeve dhe kur i ka marrë gjyqtari, di dhe të disa çështjeve të cilat janë rihedhur në short nga gjyqtarë të tjerë, për të cilat kishte kaluar tashmë afati 20-ditor.

Për sa i përket çështjeve të regjistruara për organizatat, gjyqtarja ka argumentuar se këto kërkesa janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor përsëri për shkaqe të pavarura nga veprimtaria e gjyqtarit... . Megjithatë do t'i lëmë të na i shpjegojë vetë gjyqtarja sepse është këtu.

Dhe në përfundim të kundërshtimeve, të cilat të gjithë jemi njohur, ka kërkuar 15 pikë pasi të dhënat statistikore në lidhje me respektimin e afateve, duhet të vlerësohen në raport me volumin shumë të lartë të çështjeve për periudhën kohore nga 2019 deri në momentin e vlerësimit, si dhe respektimin e procedurave ligjore dhe parimeve të së drejtës procedurale civile në shqyrtimin e këtyre çështjeve, duke përmendur, le të themi, disa parime.

Argumentet e parashtruar nga gjyqtarja lidhur me ngarkesën e lartë të punës janë mbajtur në vëmendje nga ana e këtij Komisioni (nga ana ime) në përpilimin e këtij projektraporti.

Në lidhje me 2.A.b Plotësimin e standardeve minimale kohore.

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

a) raportin e çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 84.8%;

80

b) mendimi i kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit viti 2022, ku rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 706 çështje, nga të cilat 172 çështje me palë kundërshtare ose 43% më tepër se standardi minimal sasior i punës;

d) ngarkesa e lartë e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit dhe numri i lartë i çështjeve të mbartura (1366 çështje) të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve dhe për pasojë në pamundësinë e respektimit të standardeve orientuese për përfundimin e gjykimit të çështjeve;

e) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të dosjeve nga gjyqtarë të tjerë;

f) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore; pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me 2.A.c Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Në tërësi, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe sipas metodologjisë dhe ky standard do të pikëzohet me 1 pikë. Bazuar në të njëjtat argumente sikurse janë mbajtur në vëmendje edhe tek plotësimi i standardeve minimale kohore, apo respektimi i afateve ligjore, janë mbajtur në vëmendje nga ana jonë, pra volumi i lartë i çështjeve, papritshmëria e shartimeve disa herë brenda vitit nga gjyqtarë të tjerë për shkak edhe të procesit të vetting-ut, kam vlerësuar se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me 2.A.ç Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (706), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (1,101), rezulton 64%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit zëvendëskryetari i gjykatës dhe gjyqtarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin maksimal, duke parashtruar se një nga faktorët që ka ndikuar në mos shqyrtimin e kërkesave me objekt lëshim urdhër ekzekutimi përveç

faktorit të mbingarkesës ka ndikuar dhe dërgimi në Gjykatë Kushtetuese, i kërkesës me qëllim kontrollin përfundimtar të kushtetutshmërisë të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të K.Pr.Civile. Gjyqtarja ka theksuar se numri i çështjeve të përfunduara përfaqëson një numër të konsiderueshëm çështjesh të përfunduara për një vit kalendarik, referuar ngarkesës së punës së gjyqtarit të miratuar, duke treguar një efikasitet të lartë të punës së gjyqtarit.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi duhet të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo treguesin sasior të punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i cili përcaktohet në rastin konkret me 120 çështje me palë kundërshtare, të cilën e ka realizuar gjyqtarja.

Lidhur me rritjen e papritur të volumit të çështjeve evidentohet se gjatë vitit 2022, janë larguar nga detyra katër gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtares subjekt vlerësimi me përafërsisht 240 çështje, ku 120 prej tyre janë caktuar gjyqtares në datat 28 dhe 29 prill 2022, çka ka rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e punës së gjyqtares, pa përfshirë këtu çështje e caktuara me short.

Ndërkohë lidhur me treguesin sasior të punës së gjyqtares, rezulton se, për vitin 2022 ka përfunduar në total 706 çështje si relatore, nga të cilat rreth 172 çështje themeli, duke tejkaluar në këtë mënyrë standardin minimal të ngarkesës me 52 çështje, si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare (534 çështje).

Sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe shkaqeve që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtares të cilat lidhen me rritjen e papritur të numrit të çështjeve për shkak të pakësimit të numrit të gjyqtarëve (rindarja e çështjeve), ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit, mos shqyrtimin e kërkesave me

objekt lëshim urdhër ekzekutimi për shkak të dërgimit në Gjykatë Kushtetuese, me qëllim kontrollin përfundimtar të kushtetutshmërisë të shkronjës “d”, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi nga ajo që rezulton nga analiza matematikore, pasi nga kjo e fundit, duket që rendimenti si tregues i aftësive organizative të gjyqtarës, është kushtëzuar nga fluksi i prurjeve të çështjeve të reja, çka nuk është përgjegjësi e gjyqtarës dhe jo nga mungesa e produktivitetit në menaxhimin e kohës, planifikimin apo organizimin e proceseve gjyqësore.

Në lidhje me 2.A.d Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare në arsyetimin e vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar nga K.Pr.Civile, është si më poshtë:

(i) Në çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 47 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.

(ii) Në çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” është 8 ditë, dhe është më e shkurtër se afati ligjor.

(iii) Në çështjet e kategorisë “Tregtare me palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 54 ditë, pra më e gjatë.

(iv) Në çështjet e kategorisë “Tregtare pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 20 ditë, dhe është e barabartë me afatin procedural 20-ditor.

(v) Në çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune” koha mesatare e arsyetimit është 111 ditë, pra është më e gjatë se afati procedural 20-ditor.

Pra nga të gjithë komponentët rezulton se për një është i barabartë, për dy është më i gjatë, për dy është më i shkurtër.

Sipas metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, ritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Bazuar në këtë parashikim, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja lidhur me këtë tregues të pikëzohet një shkallë më lartë se ajo që i përket përqindjes së pikëzimit, pra duke u pikëzuar me 12 pikë, duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues, kompleksiteti i çështjeve, volumin, rritja e papritur e volumit të çështjeve, si dhe duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%, pra jo më shumë se një shkallë më lartë pikëzimi, sikurse e ka përcaktuar metodologjia.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke kërkuar pikëzimin maksimal me 15 pikë, pasi për vitin 2022 ka patur ngjarje dhe rrethana të ndodhura që nuk varen nga vullneti i gjyqtarit, ngjarje këto që e kanë vënë gjyqtarin në një ngarkesë pune tej kërkesave të arsyes. Gjithashtu gjyqtarja parashtron se për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve për shqyrtim është e pamundur që të respektohen në të gjitha çështjet afatet ligjore në dorëzimin e dosjeve. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile ka çështje civile me palë kundërshtare, të cilat janë komplekse, ku brenda një çështjeje është për shqyrtim padia, kundërpadia, apo ndërhyrja kryesore dhe rrjedhimisht arsyetimi i vendimit kërkon një kohë relativisht më të gjatë.

Gjyqtarja parashtron se ndodhur në këtë situatë është përpjekur që të krijojë një balancë të barabartë në raport me ngarkesën që ka pasur për vitin 2022, në lidhje me vënien në lëvizje të dosjeve të marra në short, arsyetimin e vendimeve, si dhe kohës për zhvillimin e seancave përgatitore dhe gjyqësore. Arsyetimi i vendimit është një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, pasi gjyqtari duhet të bëjë një vendim të kuptueshëm, të qartë që të përmbajë të gjithë elementët e vendimit sipas nenit 310 të K.Pr.Civile, të analizojë saktë provat ligjin dhe institutet e së drejtës civile. Rrjedhimisht arsyetimi i një vendimit të tillë në të drejtën civile kërkon kohën e mjaftueshme për t'u arsyetuar nga gjyqtari. Një faktor tjetër që ka ndikuar në punën e gjyqtarës, ka qenë edhe një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku gjyqtarja ka qenë në cilësinë e palës paditëse. Gjyqtarja argumenton se hapja e këtij procesi, normalisht ka kërkuar kohë që tek përpilimi i kërkesës padisë, parashtrimi i kundërshtimeve të deklaratës së mbrojtjes dhe pjesëmarrja personalisht në procesin civil.

Në përfundim gjyqtarja kërkon që të vlerësohet maksimalisht për këtë tregues, duke vlerësuar se raporti që del nga tabelat në lidhje me mesataren e ditëve të arsyetimit të vendimeve nuk mund të merret matematikisht, pasi për vitin 2022 që është objekt vlerësimi ka pasur ngjarje dhe rrethana që kanë ndodhur jashtë dhe pavarësisht vullnetit të gjyqtares, ngjarje që e kanë vënë gjyqtarin në një ngarkesë pune tej kërkesave të arsyes. Prandaj në llogaritjen e dorëzimit të dosjeve duhen të zbriten çështjet të cilat janë arsyetuar jashtë afatit, por që nuk janë ushtuar ankim nga palët. Po kështu duhet të shikohet në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara për vitin 2022 për këtë trup gjykues.

Në lidhje me këto kundërshtime, jemi njohur të gjithë. Është njohur edhe relatorja.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

Në lidhje me 2.B.a Numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.4 seanca por nga ana tjetër gjyqtarja ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, prandaj në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Në lidhje me 2.B.b Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Për

këto arsye në projektraport është propozuar që shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Në lidhje me 2.C Aftësinë e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Rezulton se renditja e akteve, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Në lidhje me 2.C.b Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie për këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares” është 94 pikë dhe niveli i vlerësimit është “Shkëlqyeshëm”.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”.

Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërie në funksion, duke u pikëzuar me 35 pikë.

Në lidhje me 3.B Integritetin.

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e

sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares.

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi, për vitin 2022, të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se për gjyqtaren {...}, ka pasur 4 kërkesa për përjashtim, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Gjithashtu, sipas të dhënave statistikore rezulton se subjekti i vlerësimit ka hequr dorë në 18 çështje, nga të cilat 13 kërkesa janë pranuar dhe 5 kërkesa janë rrëzuar. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në lidhje me “Numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër për efekt të metodologjisë është “I pakonsiderueshëm”.

Pra, propozimi për nivelin e përgjithshëm për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në lidhje me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar

kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet komunikim i drejtpërdrejtë.

Vlerësoj në tërësi që ka një komunikim të qartë dhe transparent duke u vlerësuar shumë e lartë dhe duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me 4.A.b Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, gjithashtu vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës është “E lartë”, dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Në lidhje me 4.B Aftësinë për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se gjyqtarja është treguar shumë e angazhuar për ngritjen dhe diskutimin mbi çështje të caktuara juridike, duke ndarë me kolegët përvojën e përfituar. Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore, gjithashtu rezulton e lartë, duhet të pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Konkretisht:

(i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues të zhvilluara në 1 (një) ditë trajnimi;

(ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në 2 (dy) ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit, lehtësuesit ose moderatorit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlloritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës, 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë si moderator me 1.5 ditë si pjesëmarrëse. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja, gjatë periudhës njëvjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 4 ditë trajnimi duke plotësuar afatin 5-ditor. Për të përmbushur afatin 5-ditor gjyqtarja ka dërguar me anë të postës elektronike më datë 28.05.2024 trajnimin e organizuar nga Qendra e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin në Holandë (SSR), në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në datat 15-17 qershor 2022, vizitë studimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave për sa i takon formimit fillestar-mentoritmit të studentëve të Shkollës së Magjistraturës, në Utrecht, Holandë.

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 4 aktivitete trajnuese të shtrira në 7 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara në Ligjin për Statusin, për këtë arsye në projektraport është propozuar që gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Në lidhje me 4.C.b Disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtares {...}, evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues si më poshtë vijon:

Referuar dosjes personale të gjyqtares subjekt vlerësimi rezulton se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.315, datë 22.07.2021 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024”, të përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 gjyqtarja {...} është miratuar si gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2021-2024. Me

vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 252, datë 07.07.2022 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023”, të ndryshuar, janë caktuar pranë gjyqtarës {...} për mentorim kandidatët për magjistratë... – janë përmendur dhe listuar emrat.

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën e datës 11.05.2024 rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve në trajnimin me temë “Provueshmëria në procesin gjyqësor; arsyetimi i provueshmërisë së fakteve ligjore në proceset penale dhe civile: standardet e provueshmërisë; relevanca, besueshmëria dhe forca bindëse e provës; probabiliteti dhe provueshmëria në procesin gjyqësor; analiza e provave në arsyetimin gjyqësor dhe praktika gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datën 23 nëntor 2022 (prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).

Për gjyqtaren {...} duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë në cilësinë e lehtësueses në trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar si magjistrate gjyqtare udhëheqëse, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me 4.C.c Pjesëmarrjen e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në analizë të burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2022 nga dosja personale e gjyqtarës në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Në formularin e integruar gjyqtarja ka parashtruar se ka marrë pjesë në disa aktivitete dhe konferenca shkencore të organizuara përgjatë viteve 2013 - 2017, por asnjëra prej tyre nuk i përket periudhës së vlerësimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022, për pasojë gjyqtarja duhet të pikëzohet me 0 zero pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Pra propozimet për nivelin e vlerësimit për çdo kriter:

Kriteri i “Aftësisë profesionale të gjyqtarës” me 100 pikë "Shkëlqyeshëm" niveli i vlerësimit.

“Aftësia organizative e gjyqtarës”, 94 pikë "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, 93 pikë "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është vlerësimi i përgjithshëm me 387 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Muçi!

Atëherë zonja {...}, shkurtimisht sepse ne i kemi lexuar.

{...}: Po! Faleminderit!

Naureda Llagami: Do fokusoheni vetëm gjërat që ndoshta e mendoni ju që duhet të kenë më shumë rëndësi.

{...}: Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë ushtrimit të detyrës jam përpjekur maksimalisht për të respektuar çdo afat ligjor sepse kundërshtimi im lidhet me respektimin e afateve ligjore (që mos të kalojmë në përsëritje) dhe me kohën e arsyetimit të vendimeve.

Por unë do sqaroj disa rrethana që kanë ndodhur në vitin 2022 që kanë qenë për shkaqe të pavarura nga gjyqtari për të respektuar këto afate.

Së pari dua të bëj me dije që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në vitin 2022 ka pasur një praktikë që dosja nuk merrej direkt nga gjyqtari nga momenti që regjistrohesh. Kalonte për shortim, prandaj kam sjell në ankimin tim, që shortimi zgjaste 3 ditë (veprimi i sekretarisë), pastaj mbas dy ditësh mund ta merrte gjyqtari dosjen. Pra konstatohet që për të gjitha çështjet masa sigurimi padie dosja mund të vinte me katër deri në pesë ditë vonesë tek gjyqtari, që afati ishte ezauruar në kryesekretari, afati 5-ditor që përcakton ligji.

Tjetër. Po e njëjta praktikë ndiqesh edhe për veprime kundërshtime përmbaremore; po e njëjta praktikë ndiqesh edhe për çështjet që është me afat, edhe për OJF, edhe për kërkesat për ndihmë juridike. Kështu që mendoj që kjo rrethanë duhet të mbahet parasys nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Arsyet e tjera në fakt u përmendën edhe nga relatorja që ndonjëherë kërkesat për masa sigurimi të padisë është e pamundur të shqyrtohen për pesë ditë. Të gjithë kolegët që janë gjyqtarë e dinë që do bëhet njoftimi i palëve dhe po u vendos do bëhet njoftimi, patjetër duhet të marri dijeni efektivisht pala dhe nuk mund ta zhvillosh seancën sepse ke vlerësuar që duhet ta bësh në prezencë të palëve këtë masë. Kështu që është një rrethanë përsëri që nuk varet nga vullneti i gjyqtarit.

Mund të kërkohet një provë shumë e rëndësishme, se vetë paditësi është nxituar te sigurimi i padisë kur e ka paraqitur pranë gjykatës dhe nuk ka sjellë provën, për

shembull vërtetimin e pronësisë të rifreskuar. Se s'mund të vësh masë sigurimi të një pasurie që mund të jetë në emër të një të treti. Dhe vetë pala e paditur ka kërkuar që mos të shqyrtohet kjo kërkesë për sigurim padie pa u sjellë edhe kjo provë. Ose vetë pala paditëse ka vlerësuar që kjo vërtetë e ka vënë masën e sigurimit, por dua të shprehet gjykata me vendim përfundimtar. Pra nuk është një kërkesë e tillë që ai vetë e ka vlerësuar të ngutshme. Kështu që gjykata në varësi edhe të kërkesave të palëve ka menduar t'i menaxhojë edhe afatet ligjore.

Vlerësoj se në asnjë rast nuk ka ndonjë ankesë në lidhje me shqyrtimin e masave të sigurimit tej afatit 5-ditor pasi palëve i janë siguruar të drejtat procedurale pavarësisht afatit të shqyrtimit, pra nuk ka ardhur asnjë pasojë.

Tjetër. Në lidhje me shoqatat, me fondacionet. Dihet që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është e vetmja gjykatë që ka regjistrin e OJF-ve. Në fakt u sqarua gjerësisht që kemi qenë me një mungesë organike. Ka qenë nga 37, 17 gjyqtarë. Është një mungesë shumë e theksuar për vitin 2022. Imagjino shorti që do ndahesh ndërmjet 37 gjyqtarëve është ndarë midis 17 gjyqtarëve dhe përveç kësaj kolegët që janë larguar janë marrë edhe dosjet e tyre. U relatua vetë nga relatorja që vetëm në një short janë marrë 120 çështje, që është e pamundur që të menaxhohen, duke ditur që çështjet që merren nga kolegët duhet kohë që të lexohen, të shikosh veprimet procedurale që kanë kryer dhe ku do ta vazhdosh ti gjykimin në bazë të nenit 181 të K.Pr.Civile. Kështu që edhe organika ka ndikuar në këtë pjesë.

Ka marrë një rast, disa raste, se kur largohet gjyqtari normalisht edhe kërkesat që kanë qenë, shoqata, fondacione, që kanë qenë të pashqyrtuara, i kanë kaluar short trupit gjykues tjetër, dhe gjyqtari që ka pasur një numër më të madh çështjesh, nuk ka arritur që ta shqyrtojë brenda afatit që përcakton ligji shoqatën dhe fondacionin, por e ka mbajtur 8 muaj pa shqyrtuar, çka tregon që kërkesa ka qenë shumë e lartë dhe e pamundur për ta shqyrtuar. Nga ky trup gjykues është shqyrtuar brenda dy muajve. Kështu që jam përpjekur maksimalisht që çështje të cilat kanë ardhur nga kolegët dhe kanë pasur kohëzgjatje, t'i përfundoj aq sa të jetë e mundur brenda mundësive që kam pasur.

Ritheksoj pra edhe një herë që ngarkesa e lartë ka qenë e pamundur që të bëhet menaxhimi, përfundimi brenda afatit edhe të shoqatave, të regjistrimit të OJF-ve.

Përveç kësaj, duket sikur OJF-të është kërkesë për regjistrim, por ka vështirësitë e veta sepse normalisht një depozitim kërkon që të njihesh me praktikën paraprakisht, tërhiqet nga zyra e regjistrimit, mund të jetë një shoqatë shumë e vjetër në kohë dhe duhet të shikosh vendimmarrjen, kuorumin, që të verifikosh çdo mbledhje, pra çdo regjistrim që është bërë, për të verifikuar nëse është mbledhja në përputhje me ligjin apo jo. Edhe regjistrimet e reja, përsëri do lexosh komplet statutin, do lexosh komplet aktin e themelimit nëse bie në kundërshtim apo jo me ligjin.

Edhe për sa i përket kundërshtimeve veprimeve përmbarimore nga ana ime janë marrë masat menjëherë sa ka ardhur kërkesa, është vënë menjëherë në lëvizje. Vërtetë ligji parashikon rregull që shqyrtohet në dhomë këshillimi por ka kërkesa që është e pamundur që kundërshtime veprime përmbarimore të shqyrtohen në dhomë këshillimi, siç u cituan për shembull, kur mund të kundërshtohet vlera e detyrimit apo përmbaruesit, do thërritet patjetër kreditori sepse kreditori cenohet, s'mund të vesh me vlerën më të vogël. Normalisht kërkon kohën e vet; kopjen e akteve; të gjitha, që të komunikohet. Ose për shembull në rastin që do caktosh ekspert tek vlerësimi i sendit. Pra ka rrethana dhe raste të cilat nuk varen nga gjyqtari, pra përveç ngarkesës.

Këto doja që të mbaheshin parasysh pra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Edhe për respektimin e afateve në lidhje me kërkesat për ndihma juridike. Unë për shembull kam praktikën që i shqyrtoj në dhomë këshillimi dhe normalisht kam që mund ta kap afatin. Por ka raste që kërkesat vijnë shumë të paplota. Normalisht do thërras palën përpara gjykatës që të plotësojë dokumentacionin dhe të shprehem më pas.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimeve”, u tha gjerësisht që shkak kryesor është ngarkesa e lartë, se po të krahasohet për shembull vitet 2017 me 2019 ku unë kam ushtruar funksionin po në të njëjtën gjykatë, konstatohet që pothuajse nuk kam dosje fare të dorëzuara jashtë afatit. Kështu që në vitin 2022 ka qenë e pamundur të bëhet një menaxhim i këtyre dosjeve, aq më tepër kemi marrë edhe dosje nga kolegët. Kanë qenë dosje shumë të vështira, me padi, ndërhyrje kryesore,

ndërhyrje dytësore, me kundërpadi. Pra në një çështje janë pesë çështje për t'u shqyrtuar. Vetëm vendosja e palëve, të vendosësh palët në një kërkesë padi, se kjo është punë që e bën gjyqtari normalisht, me futjen e ndihmësve besoj që do lehtësohet edhe kjo pjesë, që të merret gjyqtari vetëm me pjesën arsyetuese të vendimit dhe me parashtrimin e rrethanave të faktit). Gjithashtu unë jam përpjekur që të bëj një balancë të çështjeve në arsyetimin e vendimeve. Dëgjova që dilte një përqindje e lartë në fakt tek marrëdhëniet e punës (koha ditore - s'ë mbaj mend sa - 111 ditë), por mund të ketë qenë ndonjë çështje e cila mund të ketë qenë pa të drejtë ankimi dhe në raportin që mblidhen ditët del ky afat 111 ditë. Sepse në rastet siç është që palët kanë deklaruar që ne nuk do bëjmë ankim (i kam renditur disa çështje) dhe kanë thënë nuk do bëjmë ankim, nuk kam vënë në prioritet për t'i arsyetuar sepse ajo çështje ka përfunduar. Palët madje mund ta kenë zgjidhur vetë jashtëgjyqësisht, kanë qenë dakord me vendimmarrjen e gjykatës dhe kështu që nuk i cenohet asnjë e drejtë procedurale në këtë...

Janë edhe arsye të tjera në fakt, e relatoi edhe relatorja, për shkak të detyrës, më është bërë një kronikë në vitin 2021 nga televizioni {...}. Kam bërë padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që i korrespondon vitit shtator 2021 dhe është mbyllur në korrik 2022. Normalisht edhe kjo ka kërkuar kohën e vet sepse do bësh kërkesëpadinë, do bësh prapësimet e deklaratës së mbrojtjes, do paraqitesh vetë në gjykim se detyrimisht duhet ta mbrosh çështjen vetë, ta çosh deri në fund. Kjo çështje është zgjidhur me mirëkuptim nga vetë televizioni {...}. Pranoi të hiqte shkrimet. Kështu që u pushua nga ana ime. Dhe për këto arsye unë vlerësoj të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë gjyqësor se raporti që del nga tabelat në lidhje me mesataren e arsyetimit të vendimeve nuk mund të merret matematikisht për vitin 2022 që është objekt vlerësimi të përshpejtuar, pasi ka pasur ngjarje dhe rrethana të ndodhura që nuk varen nga vullneti i gjyqtarit, ngjarje këto që e kanë vënë gjyqtarin në një ngarkesë pune tej kërkesave të arsyes, prandaj në llogaritjen e dorëzimit të dosjeve duhen zbritur çështje të cilat janë arsyetuar jashtë afatit por nuk kanë qenë ushtruar të drejtë ankimi nga palët. Po kështu duhet të shikohet në raport me numrin e çështjeve të çështjeve të shqyrtuara për vitin 2022 për këtë trup gjykues dhe duke marrë në konsideratë arsyet objektive të

parashtruara edhe më sipër. Pra po të shikojmë, janë përfunduar 706 çështje (po marrim mesataren 230 ditë pune), duke pasur parasysh që janë zhvilluar rregullisht seanca gjyqësore, duke pasur parasysh që janë kryer veprime paraprake, janë zhvilluar seanca përgatitore, është e pamundur që të menaxhohet më mirë se kaq kjo punë.

Unë duke shpresuar që kërkesa ime do pranohet.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Anila.

Fjala për relatore.

Emona Muçi: Atëherë, të më falni, në pjesën e mbledhjes së pikëve në momentin përfundimtar. Në lidhje me propozimin për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit, për kriterin e “Aftësisë organizative” ka 91 pikë dhe vlerësimi i përgjithshëm është 384. Më falni. Sikurse edhe juve jeni në dijeni, e kemi njoftuar, dhe ju për të cilin keni bërë kundërshtime. Dhe të gjitha këto janë bërë me qëllim që të... domethënë si propozim nga ana ime si relatore në lidhje me të gjithë vlerësimin tuaj, rekomandoj që pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizohet puna në një mënyrë dhe të menaxhohet koha duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve për të cilat ligji parashikon një afat ligjor dhe ato duhet të gjykohen, dhe gjyqtarja duhet të mbajë në konsideratë dhe pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale. Faleminderit!

{...}: Në fakt unë vlerësoj për pjesëmarrjen në aktivitete jashtëgjyqësore. Po të shikohen vitet e mëparshme unë kam qenë shumë aktive. Kam qenë pedagoge e jashtme, kam marrë pjesë në konferenca shkencore, kam bërë edhe shkrime. Por viti 2022 ka qenë i pamundur që unë të jepja mësim, të ushtroja veprimtari jashtëgjyqësore për shkak se jam përkushtuar vetëm detyrës, duke pasur parasysh që misioni im dhe funksioni im kryesor është të japë drejtësi. Prandaj kjo është arsyeja që e kam pasur të pamundur.

Dhe një gjë doja të shtoja në lidhje me shkrimet. Në fakt ai është kriter ligjor dhe unë prandaj s’e kam ankimuar. Por unë vlerësoj, për shembull, duke qenë se unë kam

96

një kohë shumë të gjatë që jam tek seksioni civil dhe shkrimet që mund t'i bëj më lehtë është në fushën civile. Por unë personalisht e kam shumë të vështirë të bëj një shkrim në fushën civile sepse nesër kur të jem përpara një vendimmarrje, në qoftë se do kem bërë një temë për parashkrimin fitues, në qoftë se do kem bërë temë e zëmë për të drejtën e pronësisë, palët ta relatojnë dhe normalisht në thelb, në thonjëza është një shfaqje mendimi dhe shkrimet që kam bërë unë, gjithmonë jam përpjekur që të jenë në kuadër kushtetues ose në kuadër të juridiksionit sepse që të mos citolesh... mua më ka ndodhur për shembull tek shkrimi që bëra për juridiksionin, më ka cituar vetë pala sipas shkrimit që ke mbajtur numër kaq, datë kaq. Dhe unë vlerësoj që të paktën gjyqtari, ai është kriter ligjor, dhe që duhet të adresohet në Kuvend, gjyqtari flet me vendime normalisht dhe në vendime aty do shikohet se si e zbaton të drejtën, se si është njohës i konventave të ndryshme, njohës i Kushtetutës, i ligjit, etj. Pastaj pjesëmarrja, mund të japi leksione, etj., por të bëjë shkrime në fushën... ose do detyrohesh për të plotësuar kriterin ligjor do bëj një shkrim në fushën penale që mua do më hajë shumë kohë, duhet të mbledh praktikën e kolegëve, që të japë opinionin për atë fushë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Nga kolegët e tjerë ndonjë pyetje?

Albens Tabaku: Kam unë për të folur.

Quhem Albens Tabaku.

E kam lexuar me shumë vëmendje raportin tuaj dhe mendoj që faktet prezumojnë në favorin e gjyqtares. Viti 2021-2022 ka qenë pjesa pas pandemisë, pra ishte një faktor madhor. Kemi pjesën e grevës së avokatëve që ishte qershor 2022. Prezumon në favor të gjyqtares. Ndoshta po shpreh mendimin por ky është mendimi tim. Kemi rastin e vetting-ut që ishte pjesa e valës goditëse, që ishte pjesa më e madhe e vitit 2021-2022. Kështu që fakti që kohëzgjatja nuk janë shkaqe që varen nga gjyqtarja.

Po kështu shikoj që çështjet tregtare të cilat janë komplekse si në aspektin faktik, praktik, ligjor, por si në aspektin e trajtimit, kërkojnë kohë shumë të gjatë. Njëkohësisht vlerësoj faktin që gjyqtarja ka kërkuar nga institucionet e administratës shtetërore ekzekutive, ka kërkuar dokumentacione, ka kërkuar informacione dhe në kushtet e një sistemi shumë të mbyllur dixhital është shumë e vështirë të marrësh, aq më tepër edhe t'ua vësh palëve në dispozicion. Kjo është një vlerë e shtuar. Kështu që në aspektin e kohëzgjatjes unë mendoj që duhet të marrë pikët maksimale.

Një sugjerim do kisha që në arsyetimet e vendimeve, ndoshta është më mirë, për shkak të dinamikës, të mos humbë aktualiteti, kujtesa zbehet, etj., ndoshta duhet mbajtur, por e kemi parasysh që këto janë kohëra të vështira dhe emergjente. Mendoj që kërkesa është e pranueshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Se ju praktikisht dhatë vendimin tuaj dhe...

Albens Tabaku: Po!

Naureda Llagami: Tani duhet ta ndryshojmë një çik se jemi në..

Po, dhatë opinion. Dhatë vendimin.

Shumë faleminderit zonja {...} për prezencën dhe për parashtrimet.

Nga ana e Këshillit do merren parasysh të gjitha, por mos harrojmë që Këshilli ka disa standarde që në fakt edhe zoti Albens akoma nuk është njohur dhe unë do ftoja të gjithë gjyqtarët e Tiranës në fakt ta rishikonin dhe të jepnin kontribut mbi rishikimin, qoftë edhe të metodologjisë së vlerësimit, ku mendojnë ato që nuk reflekton me të vërtetë punën e tyre ashtu siç duhet. Sepse kjo çështje në fakt ka qenë objekt diskutimi nga Këshilli edhe në kolegë të tjerë këtu dhe mund të jetë prapë në fokus për kolegë të tjerë që do i kemi në vlerësim. Në fakt do isha shumë e hapur si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor që për çdo opinion që keni mbi zbatimin e metodologjisë, ndoshta pse jo, apo të ligjit, që ka ardhur koha që nuk reflekton me të vërtetë dinamikën apo kushtet faktike

98

që ju keni, ka ardhur koha që ne ta rishikojmë atë. Kështu që do ju ftoja, ndoshta jo të shkruani artikuj për sa i përket penales por pse jo të fokusoheni për të ndihmuar me kontributin tuaj Këshillin e Lartë Gjyqësor në këtë proces që po bën.

Shumë faleminderit!

Mund të vazhdoni!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja zonja {...}).

Naureda Llagami: Atëherë, kemi diskutime mbi...

Ky është standardi, po!

Atëherë, fjalën e ka relatorja, pasi dëgjoi kundërshtimet e magistrates, nëse ka ndonjë gjë për të shtuar dhe për të reflektuar mbi vlerësimin e saj.

Emona Muçi: Atëherë, në cilësinë e relatores, pasi u njoha edhe me parashtrimet dhe provat e paraqitura rishtazi nga gjyqtarja për të provuar që disa çështje për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore është bërë shortimi dhe kalimi i çështjeve me vonesë, që vlerësoj që nuk është në përgjegjësi dhe nuk është rrethanë që duhet të penalizojë gjyqtaren, vlerësoj që ka vend për të ndryshuar propozimin lidhur me nivelin e vlerësimit, duke propozuar që gjyqtarja lidhur me këtë tregues të vlerësohet me 12 pikë. Po, nga 9. Një nivel.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim propozimin që vetë relatorja e pranon.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Atëherë, unë jam kundër lidhur me këtë propozim, për sa i përket rritjes në afatet e arsyetimit. Unë e di problematikën e Tiranës për sa i përket çështjeve, datës së regjistrimit dhe momenti kur merren nga gjyqtarët, por konstatoj se ato janë marrë parasysh nga ana e relatores kur është propozuar rritja me dy nivele.

Në mosarritjen e nivelit, domethënë që nuk jam dakord lidhur me këtë propozim është edhe fakti se numri i çështjeve të cilat kanë qenë me afat ligjor, në raport me

numrin e çështjeve të tjera është shumë i vogël dhe pasur parasysh edhe gjyqtarët e tjerë të cilët kanë gjykuar mbi 200 apo 300 çështje me afat ligjor dhe kjo përqindje e çështjeve të shqyrtuara brenda afatit ligjor ka qenë shumë e ulët, unë për të mbajtur të njëjtin qëndrim që kam mbajtur tek gjyqtarët e tjerë, jam kundër këtij propozimi.

Gentiana Muçaj: Edhe unë kundër jam.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Unë jam dakord dhe e shpreha mendimin tim. Kështu që të rriten pikët.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë magjistrates i rriten 3 pikë duke shkuar në total në 387 pikë. Nuk ndryshon niveli i vlerësimit. Pra mbetet gjithmonë "Shkëlqyeshëm".

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projekt-aktit, pasi u miratua edhe ky propozim i relatores.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord, duke qenë se u miratua.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Pra miratohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...} për vitin 2022, vlerësuar me nivel të përgjithshëm vlerësimi "Shkëlqyeshëm" me gjithsej 387 pikë.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Irena Plaku.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
8. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë në vlerësimin e dytë për të njëjtën magjistrate. Bëhet fjalë për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2013-2016. Sjell në vëmendje që gjyqtarja për këtë raport nuk ka kundërshtime, pra është dakord me atë që

ka bërë relatorja. Kështu që unë do i propozoja relatores, në kushtet që s’kemi kundërshtime, një përmbledhje shkurtimisht të gjetjeve të raportit.

Irena Plaku: Atëherë, faleminderit!

Po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit për të cilën gjyqtarja është njoftuar dhe nuk ka paraqitur kundërshtime.

Procedura për vlerësimin ka filluar me vendimin me nr. 725, të datës 07.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Janë kryer të gjitha procedurat për kryerjen e shortit dhe administrimin e burimeve të vlerësimit dhe më pas me vendimin e datës 03.06.2024, nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Profesionale është gjetur i plotë dokumentacioni.

Si burim vlerësimi janë Formulari i Vetëvlerësimit, të dhënat statistikore, dosja personale, dosjet e përzgjedhura me short. Atëherë, deri tek faqja 35 janë përshkruar dosjet burim vlerësimi.

Atëherë, në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht për treguesin 1.A.A. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, është konstatuar se, është arritur në konkluzionin se spikat aftësia e gjyqtares për paraqitjen dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes” është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. Aftësia për të interpretuar ligjin. Edhe për këtë tregues rezulton se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë evidentohet kujdesi i gjyqtarës në interpretimin e ligjit si material dhe procedural në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjeve. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante të Gjykatës së Lartë (vendimeve unifikuese), praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe për të zbatuar parimet e së drejtës. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë, duke e vlerësuar me 25 pikë.

1.B.A. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Edhe për këtë tregues rezulton se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë. Përdor të gjitha rregullat gramatikore. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në ato raste kur është e pashmangshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë kuptimi jepet në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik.

Referuar sa më sipër vlerësoj se lidhur me këtë tregues, aftësia e saj është shumë e lartë. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit.

Lidhur me 1.B.B. Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar e vendimit.

Edhe lidhur me këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka një strukturë standarde, e cila identifikon edhe të ndarë në nëntituj, pjesa përshkuese-arsyetuese, të cilat e bëjnë më të kuptueshme vendimin.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme si në aspektin vizual ashtu dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri

vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen.

Referuar sa më sipër propozoj pikëzimin me 10 pikë për këtë tregues.

1.B.C. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik. Edhe për këtë tregues rezulton se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë. Në secilin vendim burim vlerësimi ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimit të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimit është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim dhe kryesisht në aspektin thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Referuar sa më sipër propozoj pikëzimin me 25 pikë.

Sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtarës”. Për treguesin 2.A.A. Respektimi i afateve ligjore. Nga burimet e vlerësimit ka rezultuar, duke qenë se burim vlerësimi për periudhën 2013-2016 janë vetëm 11 dosjet e përzgjedhura me short dhe tre vendime të zgjedhura nga gjyqtari, pasi të dhënat e tjera statistikore nuk japin të dhëna lidhur me këtë tregues. Nga këto 11 dosje dhe tre vendimet e zgjedhura rezulton se vetëm për një kërkesë që parashikon afat ligjor, konkretisht kërkesa me objekt “Lehtësimin e arrestit dhe caktim mase sigurimi personal”, kjo kërkesë është shqyrtuar brenda afatit 48 orë. Sa më sipër rezulton se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit është 0%. Për këtë arsye për gjyqtarin propozohet pikëzimi me 15 pikë.

2.A.B. Plotësimi i standardeve minimale. Nga burimet e vlerësimit në projektraport janë arsyetuar të gjitha dosjet një për një se kush ka qenë shqyrtuar brenda afatit dhe kush është jashtë afatit, duke marrë parasysh dhe të dhënat, dhe në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se standardi sasior minimal kohor në fuqi është respektuar në 80% të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit përqindja matematikore prej 20% përkon me nivelin e vlerësimit 4, që është mbi 10-20 për qind. Gjithashtu janë analizuar edhe çështje për të

cilat ka kaluar standardi minimal kohor dhe ka rezultuar që çështjet, domethënë ai 20%, ka rezultuar që nuk është shkaktuar për shkak të gjyqtares.

Për sa më sipër për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave, konkretisht: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (3 nga 15 çështje të gjykuara) që rezulton 20%; (ii) ngarkesën e gjyqtares relatore për periudhën e vlerësimit (ka gjykuar 1154 çështje, nga të cilat 608 janë çështje me palë kundërshtare); (iii) faktin se ajo e ka tejkuluar standardin sasior mesatare me 100 çështje për të gjithë periudhën 3-vjeçare, pra më shumë se 50% të çështjeve me palë kundërshtare (duke pasur parasysh faktin që kjo e fundit ka qenë në një periudhë të vlerësimit ka qenë në cilësinë e kryetares së gjykatës); (iv) faktin se gjatë vitit 2013 – 2014 e ka ushtruar edhe detyrën e kryetares dhe prej muajit qershor - korrik 2015 ka qenë me leje studimore; (v) angazhimin e gjyqtares në trupa gjykues; është propozuar rritja me një nivel duke e rritur me 5 pikë.

2.A.C. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Ka rezultuar se koha mesatare është si më poshtë, është më e shkurtër se standardi minimal, për nga 4 (katër) kategori çështjesh, standardi është tejkuluar në vetëm 2 prej tyre, duke e pikëzuar me 3 pikë.

Në projektraport janë analizuar edhe çështjet për të cilat është tejkuluar afati, kategoria e çështjeve. Kështu po t'i zbresim në një kategori lejen e zakonshme, rezulton se koha është brenda standardit minimal prej 6 muajsh. Sa më sipër del që standardi minimal është tejkuluar vetëm në një kategori.

Referuar sa më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve më e gjatë se standardi për kategoritë e çështjeve, e cila pikëzohet me 3 pikë, mbështetet në të njëjtën analizë si treguesit e mësipërm, konkretisht: ngarkesën e gjyqtares; shkaqet e shtyrjes së çështjeve civile të themelit të cilat kanë qenë vetëm për shkaqe procedurale dhe në asnjë rast për shkaqe të gjyqtares; kompleksitetin e çështjes, ku është dashur marrja edhe e provës me ekspert (grup ekspertësh si dhe përjashtimi i ekspertëve, faktin se është vetëm një çështje, e cila ka tejkuluar afatin prej dy muajsh të standardit minimal kohor, në raport me 12 çështje të tjera penale themeli dhe civile themeli), është propozuar rritja me një... në fakt

në këtë rast, duke qenë se kanë kaluar me tre, domethënë është propozuar rritja vetëm me një nivel, duke e rritur në 4 pikë.

Sa i përket treguesit “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit për të gjitha çështjet ka rezultuar më e shkurtër ose i barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

2.B.A. Numri mesatar i seancave, ka rezultuar se numri mesatar i seancave ka rezultuar 5.5 për të gjitha kategoritë e çështjeve. Janë marrë në vëzhgim të gjitha dosjet. Në çdo rast ka rezultuar që shtyrjet kanë qenë për shkaqe procedurale për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342. Por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtarja cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg. Konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht. Por, në tërësi, shtyrjet kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë. Aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është vlerësuar shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit. Edhe për këtë tregues është vlerësuar aftësia e gjyqtarës shumë e lartë, pasi gjyqtarja ka kryer të gjitha veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil.

Për sa më sipër është propozuar pikëzimi i saj për këtë tregues 20 pikë që është aftësia shumë e lartë.

2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes. Ka rezultuar se për këtë tregues aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë. Rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie

shumë të lartë në lidhje me këtë tregues, pasi të gjitha aktet e dosjes janë të renditura sipas rregullit.

2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit. Nuk është vërejtur asnjë mungesë në lidhje me dokumentacionin e dosjes apo dokumentacion që nuk i përket kësaj dosjeje. Për këtë arsye është vlerësuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për sa i përket “Aftësisë organizative të gjyqtarës” është 99 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket treguesit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, Etika në punë është shumë e lartë, duke qenë se nuk ka të dhëna që mund të ndikojnë në këtë tregues.

Edhe për sa i përket “Paanshmërisë së gjyqtarës”, konkretisht “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” nuk rezulton që të ketë përdorur gjuhë diskriminuese.

Sa i përket treguesit “Shmangia e përdorimit të gjuhës” u propozua pikëzimi me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave për përjashtim”, nuk ka rezultuar gjatë periudhës së vlerësimit të ketë kërkesa për përjashtim. Për sa më sipër vlerësohet i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit për kriterin e tretë është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent. Rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në këtë tregues.

Edhe për sa i përket 4.A.b. Respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nuk ka të dhëna që mund të merren lidhur me këtë tregues, të cilat ndikojnë në uljen e këtij niveli, por duke qenë se është gjyqtare, prezumohet se ka treguar kujdes maksimal në ruajtjen e konfidencialitetit. Për këtë arsye është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar, si me kolegët dhe me administratën, ka rezultuar shumë e lartë, duke propozuar pikëzimin përkatësisht me 15 dhe 10 pikë.

4.C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera. 4.C.a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues. 46 ditë trajnimi. Është brenda kategorive, 5-120 ditë.

4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr gjyqtarë, ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe ka qenë në cilësinë e lehtësueses dhe ekspertes në tre aktivitete zhvilluar në 5 ditë. Për këtë arsye është propozuar me 5 pikë.

4.C.c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale. Rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në dy konferenca shkencore. Për këtë është propozuar dhe pikëzimi me 5 pikë për këtë tregues.

Gjithashtu edhe për 4.C.ç. Publikimet ligjore, rezulton se gjyqtarja ka botuar gjatë periudhës së vlerësimit rreth katër artikuj shkencorë. Për këtë arsye është propozuar edhe pikëzimi për këtë tregues me 5 pikë.

Atëherë, niveli i vlerësimit për kriterin e katërt është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për katër kriteret e vlerësimit është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtares është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia organizative 99 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia personale dhe angazhimi profesional 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm është 399 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Plaku mbi relatimin e vlerësimit etik dhe profesional.

Nëse nuk kemi diskutime mbi sa propozohet nga relatorja atëherë unë do

propozoja që të kalonim pa vonesë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...} për periudhën 2016-2016, duke e vlerësuar atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm" me 399 pikë.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:33 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Bledar Bajri** (anëtar)
8. **Albens Tabaku** (anëtar)
9. **Markelian Koça** (anëtar)

10. Yllka Rupa (anëtare)

11. Emona Muçi (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Valbona Bala, përfaqësuese e projektit EWMI. (në sallë)*
- 6. Olta Lolo, përfaqësuese e projektit EWMI.*
- 7. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice. (në sallë)*
- 8. Danela Hysenaj, përfaqësuese pranë OSCE PiA.*
- 9. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Edmon Hoxhaj, BIRN.*
- 11. Petrika Thano, MCA-PRESS.*
- 12. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 13. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Viojmë me delegimin dhe më pas kemi atë aktin që e spostuam për në fund (*shih procesverbalin e pikave 2 dhe 3*).

Pra kemi caktimin, jo delegimin, ndjesë. Caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Ka ardhur një kërkesë nga Gjykata e Beratit që kërkon plotësim trupe. Dhe Gjyrokastra.

Shkurtimisht ia jap fjalën zotit Koça që të relatojë projekt-aktet.

Markelian Koça: Po, faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Rezulton se deri më datë 12.09.2024, pranë KLGJ-së, është për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas të dhënave të mëposhtme: Çështja është penale; Akuza “Prodhim dhe shitje e narkotikëve, kryer në bashkëpunim”. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohen, 2. Numri i kërkesës {...}. Numri i çështjes {...}.

Referuar përcaktimeve ligjore të nenit 45 të ligjit “Për statusin” dhe Rregullores së nxjerrë në bazë të këtij ligji nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të plotësohet nevoja e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me skemën e delegimit, pra me mekanizmin e skemës së delegimit dhe po ashtu edhe nëpërmjet transferimit të përkohshëm meqenëse kërkohet caktimi për një çështje të caktuar dhe transferimi i përkohshëm i një gjyqtari nuk do të ishte efektiv dhe do të sillte problematikë në gjykatën ku ushtron detyrën në mënyrë të përhershme.

Në këto kushte mekanizmi që duhet të zbatohet sipas Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është ai i parashikuar nga neni 170/1, i Ligjit nr. 96/2016, për caktimin e një gjyqtari për një çështje gjyqësore të veçantë, referuar edhe rregullores, vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në konsideratë të përcaktimeve të mësipërme ligjore, referuar paragrafit IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-së të cituar më lart, si dhe në zbatim të paragrafit V, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon mbledhjes plenare që:

114

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (duke marrë në konsideratë afërsinë gjeografike dhe ngarkesën e gjyqtarëve të kësaj gjykate).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë penale të jetë 2 (dy).

Për sa më lart, Komisioni propozon për një çështje për të cilën kërkohen dy gjyqtarë, të përzgjidhen me short 2 (dy) gjyqtarë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seksioni penal.

Ndërsa, në lidhje me përjashtimet nga shorti propozohet që të përjashtohet nga shorti për shkak të detyrës që kryen, kryetarja në detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, konkretisht: znj. {...}, nisur nga ngarkesa e punës si dhe fakti që kryesimi i gjykatës kërkon një punë shtesë.

Sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një skemë e tillë e caktimit të gjyqtarëve, për ato çështje gjyqësore të veçanta të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, konsideron, përveç të tjerash, jo vetëm një shpërndarje të drejtë të ngarkesës midis gjyqtarëve të gjykatës nga duhet të përzgjidhen, me short, por edhe efektivitetin e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë nga ana e administratës së vijohet me hedhjen e shortit online.

Për kërkesën 1130 gjyqtarë të përzgjedhur janë Vladimir Cjapi dhe Noel Veizi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek relatimi i kërkesës tjetër.

Markelian Koça: Atëherë, meqenëse përcaktimet ligjore janë po ato, po kaloj vetëm tek faktet konkrete.

Rezulton se deri më datë 12.09.2024, pranë KLGJ-së, është paraqitur për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, sipas të dhënave të mëposhtme: Çështja është penale. Akuza “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të delegohen/të caktohen, 1. Numri i kërkesës -{...}. Numri i çështjes –{...}.

Ashtu sikurse në çështjen e mëparshme janë gjendur të papërshtatshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe ajo e transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i referohet përcaktimeve të nenit 170/1 të ligjit 96/2016 “Për statusin” si dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në këto kushte, referuar parashikimeve ligjore, Komisioni propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët, me short, për caktimin e një gjyqtari në çështjeje të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1 (një).

Në këto kushte, për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 (një) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Lidhur me përjashtimet, propozohet si në rastin e parë, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, konkretisht: zoti {...}.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë kalojmë në hedhjen e shortit nga ana e stafit administrativ.

Për kërkesën 153, gjyqtare e përzgjedhur është znj. Edona Vajushi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Me kaq përfundojmë edhe procedurat e shortit për caktimin e gjyqtarëve në gjykatat në nevojë.

Siç e lamë kemi hedhjen e shortit për plotësimin e një nga Komisionet e Përkohshme. (Shorti dhe vijimi për këtë çështje që u la përgjysmë në fillim të mbledhjes, është i zbardhur dhe gjendet në procesverbalin e pikave 2 dhe 3 si pjesë e të njëjtit procesverbal.)

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot, faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor